



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
SEKTORI I AUDITIT TE BRENDSDHEM

RAPORT FINAL

MBI AUDITIMIN E PLOTË ME BAZË SISTEMI TË USHTRUAR NË DREJTORINE E
SHERBIMIT TE MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHERBIMI

Auditimi i plotë i ushtruar në Drejtorinë e Sherbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimi ka si objekt “Ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë së kryerjes së sherbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi” për periudhën 1.01.2018-31.12.2021.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Parathënie

Auditimi i njesise u krye mbështetur në Ligjin Nr.114/2015 Datë 22.10.2015 “Për auditimin brendshëm në sektorin publik”, Manualin e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik të miratuar me Urdhër Nr. 100, Datë 29.09.2010 të Ministrit të Financave, në Kodin Etik për auditet e brendshëm, në Kartën e Auditimit të Brendshëm”, si dhe në programin e auditimit të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Berat me shkresën Nr 155 Prot, datë 12.01.2022.

Qellimi i këtij auditimi është dhënia e rekomandimeve për një permiresim të punës dhe ofrimin e sigurisë për titullarin që Drejtoria e MZSH-se funksionon mbështetur në ligjet, aktet nënligjore, rregulloret, udhëzimet, rregullat e komunikimit, politikat, kontratat të nënshkruara dhe marrëveshjet, vendimet, procedurat dhe udhëzimet e miratuara nga ana e menaxhimit.

Grupi i auditimit i perberë nga z.Xhevahir Muzhaka, znj Orieta Hysanj, auditë në Sektorin e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Berat e realizoi këto detyra nga data 23.05.2022-22.06.2022.

Konkluzion :

Ne veprimtarinë e Drejtorisë së MZSH-se edhe pse ka përpjekje për permiresim të punës nga stafi i saj mbetet shumë për të bërë në drejtim të inspektimit /parandalimit të këtij sherbimi si dhe duhen të marrë masa konkrete për ndjekjen dhe zbatimin e rregullave të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, në vijim shërbimi i MZSH-së, është strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme. Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut. Drejtoria e MZSH-se funksionon në zbatim të Ligjit nr 152/2015 “Për Sherbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”. E kryen aktivitetin e saj mbështetur në Rregulloren e re të miratuar me VKM nr 520, datë 25.07.2019 “Për Sherbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”. Ky fakt ka sjelle pasoja edhe në punën e drejtorisë dhe ndarjen e detyrave të gjithësecilit.

Theksojme qe ne rregulloren për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi rregullohet menyra e organizimit për mbrojtjen nga zjarri, caktohen dhe zbatohen masat për mbrojtje nga zjarri, procedura në rast të zjarrit si dhe të drejtat dhe përgjegjesite e të punësuarve.

Kthim Përgjigje Observacionit:

Në përgjigje të shkreses me nr. 4 me nr. 3674 prot datë 20.07.2022 të mbajtur nga znj. Mimoza Xhani, me detyre ish Drejtore e Komanduar.

Auditi nuk e merr parasysh observimin e kryer pasi nuk është i shoqëruar me fakte dhe prova dokumentare shtesë që të hedhin poshtë konstatimet e lëna ne projekt – raport. Dorëzimi i detyrës i kërkuar nga auditi dhe i pretenduar nga znj. Mimoza Xhania ende nuk gjendet shkresërisht në dokumentacionin e MZSH-së. Edhe në observacionin e kryer nga Ju, nuk keni bashkëlidhur kopjen e dorëzimit të detyrës për z. Ervin Hoxhallari dhe znj. Rudina Devole, persona të cilet i citoni, si dorëzues të saj. Keni vetëm argumentin verbal individual të dorëzimit të detyrës duke ngelur ende flete dalja në ngarkimin tuaj të 1 (nje) blloku të “Proces verbal konstatim shkelje”, trajtuar në material.

I. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm.

Ne zbatim të Rekomandimeve të Sektorit të Auditimit të Brendshëm të Bashkise Berat derguar Drejtorise se MZSH se me shkresen nr 182/1 prot , date 09.04.2018, nga Drejtoria e MZSH-se eshte hartuar Plani i Veprimit ku jane pranuar te 18 rekomandimet e adresuara.

Jane zbatuar gjithsej 13 rekomandime dhe ne proces jane 5 rekomandime.
Zbatimi i rekomandimeve i detajuar paraqitet ne paragrafin hyrje, kap I-re.

II. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit

Në hartimin e buxhetit për vitet 2018 - 2021 për Drejtorinë e MZSH-se, si baze ligjore kane sherbyer procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, Buxheti sipas viteve të auditimit është vendimuar me VKB-të përkatëse të çdo viti buxhetor.

Konstatohet se buxheti për periudhën e auditimit ka rritje nga viti në vite, gjë që tregon perkujdesje dhe ne rritje cilësore të shërbimit të shprehur kjo në investimet si për ndërtesat e MZSH-së dhe në paisje me mjete të reja bashkëkohore dhe me mjete zjarrfikëse për të nderhyrë në lagjet muzeale. Nga analiza e zerave të shpenzimeve për vitet 2018 dhe 2019, vihet re se pjesën më të madhe të shpenzimeve e zënë shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore në masën rreth 88 % të planit të shpenzimeve në total, ndërsa shpenzimet operative zënë rreth 10 % të shpenzimeve të përgjithshme. Realizimi i planit në total për vitin 2018 është në masën 84.7%.

Realizimi i planit në total për vitin 2019 është në masën 87.3% dhe për vitin 2020 realizimi është në masën 69%.

Për vitin 2021 janë programuar investime nga ana e bashkisë për riparimin e godinës së MZSh-se dhe për blerje autozjarrfikëse të re.

Për vitet 2020 dhe v. 2021 ka përmirësim të buxhetit duke i dhënë përparësi rritjes së investimeve në krahasim me rritjen e pagave .

Konkretisht realizimi sipas zerave buxhetore paraqitet si më poshtë:

Për vitin 2020 shpenzimet për paga e sig shoqërore zënë 76% të realizimit të buxhetit, cka dëshmon në programimin jo real që vjeren dhe nga mos plotësimi i strukture nga 38 punonjës të programuar, faktike janë 34 punonjës.

Për vitin 2021 shpenzimet për paga e sig shoqërore zënë 54% të realizimit të buxhetit total të këtij viti , realizimi i investimit të 27.8%, kurse realizimi i pagave e sig. shoqërore është në masën 86.5 %, që vjeren dhe nga mos plotësimi i strukture nga ana e bashkisë.

Per vitin 2021, per artikullin 602 ka nje realizim ne masen 50% . Mosrealimi prej 50% nuk eshte i argumentuar nderkohe qe drejtoria ka mangesi ne plotesimin e nevojave per kancelari, materiale veshmbathje e speciale. I pyetur per aresyen e mosrealizimit te treguesve te programimit ekonomisti argumenton se kemi bere kerkesa ne bashki, por nuk jane zbatuar.

Banka dhe situacionet mujore te shpenzimeve jane te ndjekura sipas artikujve ne total te 600,601,602 nga specialistja e buxhetit te bashkise por nevojitet qe plan/fakti i shpenzimeve per artikullin 602 te detajohen dhe ndiqet ne menyre analitike, ne menyre qe MZSH te jete ne cdo kohe e informuar per fondet qe disponon dhe perdor .

III. Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, i pagave e shtesat mbi page

Për periudhën e audituar në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi ka zhvilluar aktivitetin e saj në zbatim të Vendimit nr. 810 datë 31.10.2017 dhe Vendimit nr. 434 datë 07.07.2020 të kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e Strukturës së Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi të Bashkisë Berat”. Auditimi ka marrë me përzgjedhje periudhën e auditimit për elementet e pagës të cdo punonjësi të strukturës. Llogaritja e pagës është kryer mbështetur në:

1-Vkm nr. 895 datë 21.12.2016 “Për kriteret e ecures së fitimit të gradave, njësimit e funksioneve korresponduese për cdo grade, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” që specifikon elementin e gradave të punonjësve dhe mënyrën e përftimit të saj;

2-Vkm nr. 350 datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” që përcakton pagën bazë për gradë dhe shtesat për natyrë të vecantë pune;

3-Vkm nr. 203 datë 10.04.2019 “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, që përcakton llogaritjen e orëve shtesë të punës. Për elementet e pagës “paga bazë për gradë”, “shtesa për natyrë të vecantë pune”, dhe “vjetërsia” u panë 24 listëpagesa të periudhës 2020 dhe 2021. Procedura e fundit e ndjekur nga MZSH-ja për gradimin e punonjësve është e vitit 2017, ku për secilin punonjës është dhënë grada përkatëse me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së PMNZSH-së. Paga për këta elementë në listëpagesat e vitit 2020 dhe 2021 është kryer korrektësisht në zbatim të Vkm-së nr. 350 datë 19.04.2017. Për punonjësit e rinj që janë shtuar në strukturën e drejtorisë, për periudhën e audituar, nuk është ndjekur procedura e dhënies së gradave në zbatim të Udhëzimit nr. 211 datë 03.04.2017 “Për përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të vlerësimit të gradave”. Këta punonjës janë paguar në listë pagesë me nivelin bazë “Asistent zjarrëfikës”, grade të cilën nuk e kanë përfituar për shkak të mungesës së procedurës që duhet të ishte kryer në zbatim të pikës 2 të nenit 24 të Ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” . Vazhdimësia e pagesës në këtë formë sjellë 2 (dy) anomali: 1-Pagesën e punonjësit i cili është pjesë e strukturës së MZSH-së e cila përcakton me gradën dhe rrjedhimisht pagesa kryhet në bazë të gradës së përfituar në zbatim të nenit 31, pika 1 gërma a) të Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”; 2-Mos gradimi në kohën e duhur të punonjësve është penalizuese për karrierën e tyre në vazhdimësi dhe paga korresponduese për nivelin e gradës që secili meriton të përfitojë në zbatim të nenit 25 të Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” ;

Pagesa për elementin e pagës “vjetërsi”, për punonjësit e Mzsh-së kryhet mbështetur në pikën 3 të Vkm-së nr. 350 datë 19.04.2017. Nga auditimi i listepagesave u konstatua se punonjësi Dilaver Grëmshi për periudhën Tetor 2020 – Dhjetor 2021 është paguar 17,345 leke me pak (nga financa është trajtuar vjetërsia mbështetur në urdhërin e shkepupes së marrëdhënies së punës Nentor 2017), por nuk ka gjurmë të shkepupes së marrëdhënies së punës në librezën e punës së punonjësit, por ka 2 (dy) herë fillim të pozicionit të punës. Për elementin “shtesë page për orët shtesë”, u auditua

periudha Prill – Qershor 2021, në zbatim të Vkm-së 203 datë 10.04.2019. Pagesat nga MZSH-ja për këtë element kanë filluar që nga muaji Prill 2021 dhe kanë vazhduar në vijimësi. Dokumentimi i orëve shtesë bëhej në ‘Listen e gadishmërisë’ ku përcaktohej emri i punonjësit, ora e njoftimit, ora e paraqitjes dhe orët që ka qëndruar në gadishmëri. Ky dokument firmosej nga komandanti i shërbimit dhe nga zyra e informacionit. Auditit administroi listat e gadishmërisë për periudhën Prill-Qershor 2021, listë prezencën e MZSH-së për këtë periudhë.

Gjetje:

1. *Për punonjësit e rinj që janë shtuar në strukturën e drejtorisë, pas vitit 2017, nuk është ndjekur procedura e dhënies së gradave. Këta punonjës janë paguar në listë pagesë me nivelin bazë “Asistent zjarrrëfikës”, pa e përfituar këtë gradë;*
2. *Për elementin e pagës “shtesë page për orët shtesë” ka diferenca në pagën bruto për 24 (njëzetë e katër) punonjës. Për elementin e pagës “vjetërsi”, ka diferenca në pagën bruto për 1 (një) punonjës;*

Rekomandojmë:

1. *MZSH-ja në zbatim të pikës 2 të nenit 24 të Ligjit nr. 152/2015, Udhëzimit nr. 211 datë 03.04.2017, të marrë masat e duhura për gradimin në kohë të punonjesve aktuale dhe të rinj të emëruar në strukturën e vet;*
2. *Nga personat përgjegjes për hartimin e listëpagesës së MZSH-së të bëhen veprimet korrektuese për 24 (njëzetë e katër) punonjës të gjetur me gabime, ne vlerën 30,830 leke për 16 persona paguar me pak dhe -6,359 leke për 8 persona paguar tepër në veprim dhe për 1 (një) person ne vlerën 17,345 (shtatëmbëdhjetëmijë e treqindëdyzetëpesë) lekë paguar me pak;*

Sektori i Inspektimit dhe Parandalimit

Për periudhën e audituar ky sektor ka pasur lëvizshmëri të personelit në strukturën e vet duke shkaktuar edhe vështirësi në gjetjen e dokumentacionit për kontrollat dhe inspektimet e kryera. Nga auditimi i dokumentacionit të këtij këtij sektori u pa se situata dokumentare ka ndryshime shumë të vogla nga auditit i fundit i kryer nga Bashkia Berat. Planet e punës mujore dhe vjetore janë shumë të përgjithshme në formulimin e tyre, duke mos specifikuar cilat objekte do të auditohen në zbatim të rrezikshmërisë së tyre të specifikuar në kreun i të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020 “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe dhënia e Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri”. Nga regjistri i akteve të kontrollit për periudhën 2018 – 2021, janë kryer 244 akte kontrolli nga të cilat nuk është vensodur asnjë masa administrative për mospërbushje të rregullave teknike të mbrojtjes nga zjarri. Janë plotësuar vetëm blloqet e akteve të kontrollit dhe vetëm 2 fletë të bllokut të akteve të inspektimit të dokumentacionit të bërë hyrje në datë 26.05.2021. Për blloqet e mëparshme nuk mund të gjendet tërësia e tyre pasi hyrja e parafundit ka qënë me datë 20.02.2017 dhe u verifikuan nga auditit vetëm blloqet e gjobave (letra me vlerë). Nga kqyrja e dokumentacionit të fletë hyrjeve dhe fletë daljeve të magazinës në lidhje me dokumentacionin (blloqet) e nevojshme për zhvillimin e punës së këtij sektori u vërejt se janë bërë hyrje në vitin 2017 dhe 2021 dhe nga magazinieri në detyrë është gjykuar ti behet dalje e gjithë sasia inspektorit në detyrë. Për vitin 2017, me fletë hyrjen nr. 6 datë 20.02.2017 dhe me fletë daljen me nr. extra pa datë e firmosur nga znj. Rudina Devole me detyrë magazinieri dhe znj. Mimoza Xhani me detyrë inspektore. Për blloqet të cilat ka në ngarkim znj. Mimoza Xhani, me fletë daljen me nr. extra pa datë, nuk u gjend gjurmë dokumentacioni në vijimësi të dorëzimit të tyre në përfundim të detyrës së znj. Mimoza Xhani. Gjatë periudhës së auditimit, znj. Mimoza Xhani erdhi dhe konstatoi gjendjen e blloqeve që gjenden në Mzsh dhe nuk vendosi në dispozicion të auditit dorëzimin shpresor të detyrës dhe të blloqeve që kish në ngarkim, sikundër e pretendon verbalisht që ka kryer dorëzimin e tyre. Në tërësi dhe vecanërisht për blloqet e gjobave

respektivisht, 2 (dy) blloqe “Proces verbal konstatimi shkelje” dhe 2(dy) blloqe “K.V.P Konstatim shkelje”, nga personeli aktual i Mzsh-se dhe nga znj. Mimoza Xhani u kërkuar në ambientet e Mzsh-se dhe u gjeten 3 blloqe në mungesë të njërit. Blloku që mungon është “Proces verbal konstatim shkelje”, i cila është bllok gjobash ose letra me vlerë që duhet të ndiqen me përgjegjësi të plotë nga personi që e ka në ngarkim dhe nga financa të kryhet inventarizimi në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 80. Drejtoria e financës ka shkarkuar nga magazina e saj totalin e blloqeve, të cilat janë bërë hyrje në magazinën e MZSh-së (duplikim magazine), dhe sërish janë bërë dalje në total inspektorit në detyrë, duke mos ndjekur vazhdimësinë e tyre, dhe duke ia transferuar ndjekjen e personit i cili e ka në ngarkim. Në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, neni 50, vlera minimale e sanksioneve në plotësi të bllokut të gjobave është 5,000 lekë. Vlera e bllokut të humbur është 30flete*5,000 lekë/fleta=150,000 lekë në ngarkim të znj. Mimoza Xhani. Flete hyrja e rradhës është me nr. 8 datë 26.05.2021 në të cilën janë specifikuar numrat seriale për të gjitha blloqet e bërë hyrje. Të gjitha blloqet i janë bërë dalje z. Dilaver Gremshi me detyrë funksionale inspektor parandalimi.

Drejtoria e Mzsh-së ka rimarrë blloqe të ndryshme të dokumentacionit pa mbaruar ende blloqet e para të bëra hyrje në vitin 2017, të cilat një pjesë e konsiderueshme rezultojnë ende të paplotësuar.

Procedura e vlerësimit dhe miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri

Procedura e vlerësimit dhe miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri është e rregulluar me Vkm-në nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar, Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020 “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe dhënia e Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri”. Nga IT e bashkisë Berat, për auditin u administruar akses në sistemin E-leje. Për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021 u filtruan të gjitha dosjet që i kanë ardhur drejtorisë së MZSH-së për vlerësim dhe miratim, nga punonjësi përkatës i Bashkisë Berat. Për periudhën e audituar janë trajtuar nga Mzsh 163 dosje që janë leje ndërtimi ose leje infrastrukturore, nga të cilat 20 leje janë refuzuar dhe 143 leje janë miratuar.

Udhëzimi nr. 81 datë 06.03.2020, kreu II përcakton gjithë procedurën që duhet të ndjekë Mzsh-ja për miratimin/pezullimin/refuzimin e lejeve të ndërtimit, të cilat kanë detyrimin ligjor të kenë projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi sipa llojit të rrezikshmërisë së objektit. Auditit pa të gjitha lejet e ndërtimit të vitit 2021 (si viti i fundit i auditimit) dhe me përzgjedhje rastësore disa leje të periudhës 2018 – 2020 (tabelat tek kapitulli i të ardhurave). Si dokumentacion shkresor për miratimin dhe vlerësimin e lejeve të ndërtimit, MZSH-ja dispononte: 1-Certifikatën e Sigurisë nga Zjarri; 2-Akt detyrimin e pagesës së tarifës së aplikimit të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri të lejes së ndërtimit; 3-Pagesën e tarifës nga qytetari

Nga kqyrja e dokumentacionit shkresor për miratimet e lejeve të ndërtimit me miratimin në sistemin e-leje, u konstatuan anomalitë në lidhje me zbatimin e udhëzimit për kryerjen e procedurës. Anomalitë e konstatuara nga auditimi janë: 1.Miratimi në sistemin e-leje nga drejtuesi i institucionit është shumë i cekët në formulimin e vet duke mos specifikuar të dhënat në zbatim të pikës 5 kreu II të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020.Nuk ka gjurmë në sistemin e-leje apo në dosjen shkresore sipas formulareve tip të udhëzimit, në të cilin inspektori i autorizuar në detyrë duhet të bëjë vlerësimin e projektit të paraqitur dhe a i plotëson kriteret ligjore për miratim. Miratimi nga titullari është kryer pa këtë vlerësim; 2-Në të gjitha rastet (lejet në analitik të trajtuara në kapitullin e të ardhurave), miratimi nga titullari është kryer para kryerjes së pagesës së tarifës për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në kundërshtim me gërmën f, pika 5, kreu II të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020. Paga e tarifës nuk gjendet në sistemin e-leje por vetëm në mënyrë shkresore; 3-Certifikata e Sigurisë nga Zjarri, e gjendur në dosjen shkresore të akteve të pagesës është dokument që jepet **pasi** ka mbaruar procesi i lejës së ndërtimit dhe gjithë procedura e dhënies së saj është e parashikuar në kreun III të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020, dhe jo sikundër ka vepruar MZSH që ka dhënë shkresërisht këtë certifikatë pa kryer procedurën;4-Për vitin 2021, për të cilin u panë të

gjitha lejet e ndërtimit, nga 24 leje ndërtimi janë miratuar në heshtje 11 prej tyre duke mos respektuar afatin 7 ditor të kthim përgjigje të përcaktuar në pikën 11 të kreut II të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020.

IV. Sistemi i realizimit, raportimit dhe ndjekjes së të ardhurave.

Drejtoria e Mzsh-së në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” neni 36 pika 2 kryen shërbime të ndryshme dhe për tarifimin e tyre për periudhën e auditimit gjen zbatim Vkm nr. 285 datë 26.06.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj” dhe Vkm nr. 607 date 29.07.2020 “Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”. Auditimi u ndal tek të të ardhurat që Mzsh-ja duhet të gjenerojë nga aplikimi në sistemin e-leje për projektin e mbrojtjes nga zjarri të lejeve të ndërtimit. U panë te gjitha lejet e vitit 2021 dhe me përzgjedhje rastësore disa leje për cdo vit të periudhës 2018 – 2020, për të monitoruar të gjithë procesin e detyrimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga ky procedurë. Ekonomisti në detyrë na vendosi në dispozicion të gjitha dosjet e pagesës së tarifës për “CSZ” të dhënë nga drejtuesi i institucionit. Praktika e ndjekur nga Mzsh-ja në tarifimin e aplikimit (trajtuar të procedura), ka si vazhdimësi hartimin e akt detyrimit, i cili përpilohet të Mzsh-ja nga ekonomisti i saj, hartimin e faturës për arketim që përpilohet nga financa e bashkisë Berat dhe pagesa e kryer nga qytetari. Për dosjet elektronike të para në bazë të Vkm-së e cila ka qënë në zbatim për tarifimin e procedurës së miratimit, rezulton diferenca 72,000 lekë e paarkëtuar për shërbimin e kryer. Pjesë përbërëse e këtij materiali do të jenë edhe të gjitha lejet e ndërtimit të konfirmuara në sistemin e-leje (133 leje të konfirmuara), për të cilat duhet ndjekur vazhdimësia e pagesës në pamundes të kryhet nga auditimi, i cili ka kontrolluar 40 prej tyre ose 30 % të lejeve. Për të gjitha këto leje ndërtimi, nuk ka gjurmë të procedurës së dhënies së Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri sipas kreut III pika 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020, shprehet”1. *Certifikata e Sigurisë nga Zjarri, në vijim “CSZ”, sipas formularit nr. 2 dhe 2.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, është akti administrativ i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, nëpërmjet të cilit provohet përmbushja e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, sipas kategorizimit të objekteve.*2. *Aplikuesi për CSZ-në paraqet kërkesë nëpërmjet sistemit elektronik e-Albania, vetëm pasi kapërfunduar procesi i zhvillimit/i ndërtimit.* Tarifa për dhënien e kësaj certificate është e përcaktuar në Vkm-në nr. 607 date 29.07.2020, pika 7 “Për dhënien e certifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektet që ushtrojnë aktivitete, sipas klasifikimit të rrezikshmërisë nga zjarri, tarifa është 5,000 (pesë mijë) lekë”. Mungesa e kësaj procedure ka shkaktuar mungesë të ardhurash për MZSH-në.

Gjetje:

3. Nuk është kryer inventarizimi fizik nga Drejtoria e Financës të letrave me vlerë që MZSH-ja disponon;
4. Magazina e Bashkisë Berat dhe magazina e Mzsh-se kanë bërë dalje të gjitha blloqet (dokumentacionin) e nevojshem për inspektim punonjësit të inspektimit në detyrë;
5. U konstatu mungesa e 1 (nje) blloku “Proces verbal konstatim shkelle”, i cila është bllok gjobash ose letra me vlerë që duhet të ndiqen me përgjegjësi të plotë nga personi që e ka në ngarkim;
6. Dokumentacionit shkresor për miratimet e lejeve të ndërtimit me miratimin në sistemin e-leje, ka anomali në lidhje me zbatimin e udhëzimit përkatës për kryerjen e procedurës. Miratimi është kryer nga titullari jashtë kriterëve ligjore për dhenien e tij;
7. Pagesa për miratimin e projektit të zjarrit dhe shpëtimin nuk është kryer për të gjitha dosjet e aplikuar në sistemin e-leje. Nuk ka gjurmë të procedurës së dhënies së Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri;

Rekomandime:

3. Drejtoria e Financës duhet të administrojë blloqet e letrave dhe duhet ti ndjekë me nr. serial arkëtimin e tyre në përfundim të çdo blloku. Gjithashtu duhet të kryejë inventarizimin fizik të letrave me vlerë të paktën një herë në muaj në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 80;
4. Nga personeli i administratës së MZSH-së, me detyrë magazinier të administrohen me përgjegjësi gjithë dokumentacioni i inspektimit duke mos i bërë dalje të gjitha llojet e blloqeve në sasi;
5. Nga MZSH-ja të gjendet gjurma shkresore e vijimësisë së bllokut të gjobave, i cili është në ngakim të znj. Mimoza Xhani me vlerën 150,000 (njqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Ne rast të mos gjetjes së dokumentacionit, të ndiqet vjelja e dëmit të shkaktuar Bashkisë Berat;
6. Nga MZSH-ja në kryerjen e procedurës së miratimit vlerësimit të projekteve të zjarrit të lejeve të ndërtimit të zbatohet me korrektësi Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020. Nga Bashkia Berat, për punonjësit e sektorit të inspektimit, të merren masa për mos zbatim të detyrave funksionale dhe në mos inspektim të projekteve të zjarrit dhe shpëtimit, drejtuesit të MZSH-së për miratimin dhe vlerësimin e projektit të zjarrit dhe shpëtimit pa zbatueshmëri ligjore duke gjeneruar detyrime të paarkëtuara në kohë dhe të ardhura të munguara të Bashkisë Berat;
7. Nga MZSH-ja të ndiqet procedura e nxjerrjes së detyrimit për lejet e konfirmuara pa kryer pagesën në vlerën 72,000 (shtatëdhjetë e dy mijë) lekë si dem ekonomik i shkaktuar buxhetit të Bashkisë Berat. Nga MZSH-ja të rishihen të gjitha CSZ-të e dhëna dhe të veprohet në zbatim të kreut III të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020;

V. Sistemi i prokurimeve

Per sa i perket prokurimit te mallrave dhe shpenzimeve rezulton se fondet e MZSH-se menaxhohen nga Bashkia Berat. MZSH-ja ka ne strukturen e saj vetem 2 punonjes administrative (ekonomisti dhe magazinieri), gje qe sjell pamundesi ne zhvillimin e procedurave te prokurimit nga struktura e MZSH-se. Gjate viteve te auditimit 2018-2021 procedurat e tenderave jane zhvilluar nga Bashkia Berat. Tender te Hapur ka patur me objekt “Blerje karburanti per Bashkine Berat dhe per drejtorite vartese”.

Me kerkesat “Mbi planifikimin e karburantit per vitin e auditimit nga Drejtoria e MZSH-se Berat” jane percaktuar kerkesat per karburant ne Drejtorine e Prokurimeve te Bashkise Berat. Blerja e karburantit eshte kryer nga komisioni i prokurimit te blerjeve brenda Drejtorise se Prokurimeve ne Bashkine Berat.

Edhe procedurat e prokurimit te blerjeve te vogla jane kryer nga komisioni i prokurimit te blerjeve me vlere te vogel i perqendruar ne Bashkine Berat.

Nga ana e Drejtorise se MZSH-se jane bere hyrje materialet nga Bashkia Berat.

Procedurat e tenderimit nuk u pane per aresye se jane zhvilluar nga Bashkia Berat i cili do te jete objekt i nje auditimi te vecante.

VI. Auditimi i shpenzimeve te karburantit sipas normativave.

Llogaritja e harxhimit te karburantit per automjetet e motopompat e MZSH-se te Bashkise Berat eshte kryer ne baze te normativa e e harxhimit te karburantit per pershkrimin e 100 km, normative se harxhimit te karburantit per 60 minuta ne pune dhe normative se harxhimit te karburantit per 60 minuta ne ndezje.

Per percaktimin e normativave sipas viteve te auditimit kane dale Urdherat e Kryetarit te Bashkise per ngritjen e komisioneve per percaktimin e normativave te harxhimit te karburantit i perbere nga tre antare. Komisioni ka percaktuar normativat e karburantit per te gjitha mjetet ne dispozicion.

Mbeshetur ne Urdher dorezimin e leshuar nga drejtori i MZSH-se eshte perpiluar fletedalja nga magazinieri i njesise.

Per sa i perket konsumit te karburantit jane hartuar fleteudhetimet per cdo mjet ku jane lene gjurme per levizjet brenda dhe jashte territorit te bashkise.

U audituan me perzgjedhje dalja e karburantit per nje periudhe 6 mujore nga ku rezultoi se ajo perputhej me furnizimin per cdo mjete sipas muajve perkates.

Me perzgjedhje u ndoqen normativat e karburantit sipas viteve te auditimit duke perzgjedhur mjetet zjarrfikese qe kishin konsumin me te madh vjetor.

Dokumentat jane mbajtur ne menyre kronologjike dhe pa korrigjime. Cdo dokument vertetues eshte pasqyruar ne librin e magazines .

Duke audituar te gjitha dokumentacionin si urdher pagesat, faturat e blerjes se gazoil, flete hyrjet dhe flete daljet e magazines, flete udhetimet e perdorura per argumentimin e karburantit si dhe proces verbalat e normativave te harxhimit te karburantit duke e krahasuar me normativat e konsumit nuk rezultuan diferenca.

Gjendja e karburantit per cdo muaj e mjete eshte e mbartur per muajin pasardhes.

Per dokumentimin e karburantit jemi bazuar ne dokumentacionin e meposhtem:

1. Libri i sherbimit te Informacionit (i cili nuk eshte plotesuar si duhej), trajtuar me poshte, I cili duhej te permbante te dhenat si daten e sherbimit, njoftimet ne rastet e emergjences, personi qe ka bere njoftimin, nr i telefonit, adresa e njoftuesit, vendodhja e ngjarjes, koha e njoftimit, koha e daljes se mjeteve si dhe e mberritjes ne stacionin e MZSH-se, si dhe punonjesi i salles operative.

2. Fleta e nderhyrjes ku ka fleten e njoftimit te punonjesit te informacionit dhe raporti i situates se nderhyrjes firmosur nga komandanti i sherbimit dhe pronari i demtuar.

3. Pasqyra e Automjeteve ku perfshihet:

a). Km e pershkruar ne levizje gjate veprimeve operacionale , minutat ne pune gjate veprimeve operacionale dhe minutat ne nderhyrje per cdo automjet ku jane te firmosura nga 4 antare te sherbimit dhe komandanti i sherbimit.

b). Llogaritja e harxhimit te karburantit per cdo mjete e muaj nga ekonomisti

c). Fletet e udhetimit firmosur nga drejtori i mzsh-se , sipas flete nr te flete nderhyrjeve.

d). Proces verballi ne fund te muajit mbi rakordimin e konsumit te karburantit per automjetet firmosur nga 4 shoferat perdorues, ekonomisti dhe drejtori I mzsh-se.

e). Tabela e udhetimit per cdo mjet ku perfshihet data e udhetimit, vendi i nisjes, vendi i mberritjes, distance ne km, firmosur nga perdoruesi i mjetit dhe dhe shefi I PMNZSH-se.

Nga auditimi u konstatua se:

Gjetje Nr 8: Libri i Sherbimit të Informacionit qe mbahet nga punonjesi i salles operative ne disa raste nuk plotesohet sipas standarteve te percaktuara me te meta si me poshte:

Shkrimi i plotesimit te ngjarjes jo i kuptueshem, personi qe bene njoftimin me nr e telefonit dhe adresa e njoftuesit, jo i percaktuar ne te gjitha rastet, koha e daljes se mjetit dhe e hyrjes plotesohet ne nje kolone.

Rekomandimi Nr 8.:

- Te merren te gjitha masat nga shefi i sherbimit te MZSH-se dhe inspektori i trajnimit per plotesimin e librit te sherbimit te informacionit te salles operative me te gjitha kollonat si data e sherbimit, njoftimet ne rastet e emergjences, personi qe ka bere njoftimin, nr i telefonit, adresa e njoftuesit, vendodhja e ngjarjes, koha e njoftimit, koha e daljes se mjeteve si dhe e mberritjes ne stacionin e MZSH-se, si dhe punonjesi i salles operative, ne zbatim te ligjit nr 152/2015 “ Per Sherbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin” neni 11, pika d.

Nga kryqezimi i pasqyrave te fleteve te udhetimit me regjistrin e informacioneve te salles operative u konstatua se ne 4 raste mjeti ishte per nderhyrje operative ne orarin e ndezjes se mjetit orari 08-8.10 min, si dhe ne orarin 20.00-20.10 minuta, por ishte evidentuar dhe ne pasqyren ditore te ndezjes se mjetit, konkretisht;

Nr	Mjeti	Periudha	Aresyeja e levizjes	Ora dalje dhe kthimit	diferenc minuta
1	Iveko	03.02.021	Per shuarje zjarri prane shkolla 7 Nent	08.00-10-30	10'
2	Iveko	24.03.021	Per shuarje zjarri fshati Dyshnik	18.40-20-35	10'
3	Volvo	02.06.2021	Pastrim ambjentesh ne MZSH.	19.30-20.30	10'
4	Iveko	10.06.021	Inspektim idrantesh lagja Kala	08.00-09.30	10'
5	Volvo	27.06.021	Pastrim lagja 22 tetori	08.00-13.00	10'

-Nga perlllogaritja e normatives ne ndezje per 60 minuta sipas mjeteve, ne zbatim te Urdheri i Kryetarit te Bashkise nr 793, date 16.11.2020, ku per automjetet zjarrfikese dhe te shpetimit do te ndizen ne vend e ne ecje 2 (dy) here ne dite gjate 24 oreve , (ora 08 dhe ora 20), per ngrohje, karikim baterish e qarkullim te vajit , nga 10 (dhjete) minuta ne dite për cdo ndezje kohes ne ndezje pasqyruar me teper dhe te cmimit te furnizimit sipas datave të mjeteve rezultoi diferenca ne shumen 1504 leke, per te cilen kerkojme te zhdemtohet nga z. ekonomisti qe llogarit normativat z.Altin Bojaxhiu.

Gjetje nr 9: Eshte pasqyruar ne 5 raste ne fletet e konsumit te karburantit edhe ndezja per 10 min ne nje kohe qe mjetet kane qene ne nderhyrje ne shkelje te ligjit 10296, date 08.07.2010 Per menaxhimin financiar dhe kontrollin “ neni 14 .

Rekomandimi nr 9: Te zhdemtohet shuma 1.504 leke nga ekonomisti si veprim ne pesë raste i dubluar, kur eshte perfshire dhe koha e ndezjes 10 min , kur automjetet kane qene ne veprime operacionale si dhe te shikohet mundesia e mosndezjes se automjeteve kur ato kane kryer aktivitet afer kohes se ndezjes se programuar

Nga auditimi i vjeljes se tarifave te sherbimit per hapjen e dyerve te blinduara u evidentua se ne 4 (kater) raste jane kryher nderhyrje pa u evidentuar kryerja e sherbimit dhe vjelja e tarifes per kete sherbim ne zbatim te VKM nr 607, date 29.07.2020” Tarifat per llojet e sherbimeve qe ofrohen nga sherbimi I mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi”, ku percaktiohet tarifa 2000 leke/ per sherbimin e hapjes se dyerve te blinduara.

Konkretisht nderhyrja e sherbimit ku nuk eshte kryher pagesa eshte si me poshte:

Nr	Mjeti	Periudha	Aresyeja e levizjes	Ora dalje dhe kthimit	Personit sherbyer	Shuma per Likuidim Lekë
1	Volvo	30.08.021	Hapje dere te blinduar L. Barikade	19.47-20-17	Nadire Nadiraj	2.000
2	Volvo	09.10.021	Hapje dere blinduar L. D.Kombit	09.20-10-00	Gazment Kazazi	2.000
3	Volvo	02.06.021	Hapje dere te blinduar L. Clirim	12.30-13.30	Fatime Murati	2.000
4	Volvo	20.11.021	Hapje dere te blinduar L. Clirim	08.00-09.30	Ledion Dervishi	2.000
	Shuma					8.000

Gjetje nr 10: Eshte kryher sherbimi per hapje e 4 dyerve te blinduar te 4 familjareve sipas kerkeses se tyre pa u vjele tarifa e sherbimit ne kundershtrim me zbatim te duke sjelle shkelje te vkm te cituar me siper ne shumën 8.000 leke nga 4 familaret.

Rekomandimi nr 10. *Te zbatohet VKM nr 607, date 29.07.2020” Tarifat per llojet e sherbimeve qe ofrohen nga sherbimi i mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi”si dhe te zhdemtohet shuma 8.000 leke nga 4 familjaret qe u eshte kryher sherbimi I hapjes se dyerve te blinduara.*

8. Auditimi i funksionimit te sistemit te kontrollit te brendshëm.

a) Vleresimi i mjedisit te kontrollit te brendshem

Nga auditimi i mirefunksionimit te Drejtorise se MZSH-se u konstatua se eshte miratuar “ Rregullorja Tip e E Sherbimit te Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin” me VKM nr 520, date 25.07.2019 e cila ngarkon Ministrine e Brendshme dhe Bashkite perkatese per zbatimin e ketij vendimi. Ne nenin 24 te kesaj rregullore (Detyrat funksionale te ekonomistit te Sherbimit Vendor te MZSH-se) , pika i), percaktohet midis detyrave te tjerave te ekonomistit pergjegjsia ne “ *Perpilimin e Urdher Pagesave per te gjitha trasaksionet financiare te sherbimit te MZSH-se dhe kalimin e tyre ne Thesar dhe Banke*”, pikes dh), ku percaktohet “ *Perpilon liste pagesat e punonjesve te sherbimit per periudhen mujore*” etj

Deri me sot keto veprime i ka kryer ekonomistja e finances se Bashkise Berat, ndersa Drejtoria e MZSH-se ka sherbyer si magazine e dyte per materialet e sherbimet e kryera duke u bere hyrje ne Bashkine Berat e dalje per Drejtorine e MZSH e cila nga ana e vete u bene daljet materialet e sherbimet punonjesve te saj.

Gjetje Nr 11. Nga Drejtoria e MZSH-se ne lidhje me veprimtarine e saj ekonomiko- financiare eshte vepruar ne kundershtrim me Rregulloren Tip te Sherbimit te Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin” e miratuar me VKM nr 520, date 25.07.2019, ku Drejtoria e MZSH-se duhet te ishte njesi me bilanc me vete.

Rekomandimi Nr 11. Me Vendimarrje te Keshillit Bashkiak te miratohet Drejtoria e MZSH-se, Njesi me bilanc me vete, ne zbatim te VKM nr 520, date 25.07.2019, “ Per Miratimin e Rregullores Tip “ Per Sherbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”, nga i cila ndikon drejteperdrejt ne punen e cdo punonjesi te MZSH-se, pasi percakton ndarjen e detyrave te gjithesecilit dhe raportimin e zbatimit te tyre te personat pergjegjes sipas hierarkise.

c) Vleresimi i riskut

Nga Drejtoria e MZSH-se nuk eshte hartuar rregjistrin e riskut i mbeshetur ne objektiva te matshme dhe te realizueshme, mbeshetur ne Ligjin nr 10296 date 08.07.2010 “Per menaxhimin financiar dhe kontrollin ” neni 11, pika 2 ,neni 12 pika 3 shkronja d. Lind si detyre e Drejtorit te MZSH-se dhe nepunesit zbatues te njesise te identifikojte dhe krijoje rregjistrin e riskut ,te vleresoje dhe kontrolloje risqet qe vene ne rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses te veprimtarive te strukturave qe ata drejtojne

Nga auditimi i menaxhimit financiar dhe kontrolli i brendshem se Drejtorise se MZSH-se percaktohet Risk i Larte ne kete fushe.

-HYRJE

Raporti Final i auditimit i ushtruar ne Drejtorine e MZSH-se Berat u pergatit dhe u hartua nga grupi i auditimit i perberë nga Z. Xhevahir Muzhaka e Znj Orieta Hysanj, auditë në Sektorin e Auditimit të Brendshëm në Bashkine Berat .

Subjekti u auditua për periudhën nga 1 Dhjetor 2018 – 31.12.2021.

Grupi i auditëve e realizoi këtë detyrë gjatë periudhës 23.05.2022-22.06.2022

Lloji i auditimit : *Forma e zgjedhur sipas programit të auditimit është angazhim auditimi mbi bazë sistemi duke u fokusuar në specifikën e sherbimit e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimi, rregulloren e brendshme, si dhe vlerësimin e sistemit e kontrollit të brendshëm, nese proceset e menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe administrimit janë hartuar dhe paraqitur nga menaxhimi,*

funksionojnë në mënyrë që garantojnë përdorimin me efektivitet, eficence, ekonomi dhe në përputhje me ligjshmerine, të burimeve financiare dhe njërëzore.

Në kryerjen e misionit të Auditimit, auditit është karakterizuar nga objektiviteti dhe pavarësia në punën e tij.

Qëllimi i këtij auditimi është, vlerësimi i ligjshmerise, rregullshmerise dhe te sistemeve financiare dhe puna e kryer për zbatimin e buxhetit. Auditimi synon të ndihmojë njesine të arrijnë objektivat e saj, nëpërmjet veprimtarisë së pavarur objektive dhe të bazuar në risk, që përfshin mbështetjen e organizatës për të arritur qëllimin e saj, duke:

a. Ndihmuar titullarin të identifikojë dhe të vlerësojë risqet në organizatë;

b. Vlerësuar përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve, strukturave, vendimeve, procedurave dhe kontrolleve, pra sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollin në përgjithësi, duke u fokusuar kryesisht në:

- identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i organizatës;
- përputhshmërinë e akteve të brendshme dhe të kontratave me legjislacionin;
- besueshmërinë dhe gjithpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
- kryerjen e veprimtarive me kursim, dobi dhe frytshmëri;
- ruajtjen e asetëve dhe të informacionit; dhe
- përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve

Drejtorja e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi, është një strukturë e specializuar e gatishmërisë së përhershme.

Misioni i këtij shërbimi është inspektimi, parandalimi, me masat e mbrojtjes nga zjarri, ndërhyrja për shuarjen e zjarreve, shpëtimi i jetës, gjësë së gjallë, pronës, mjedisit, pyjeve dhe kullotave në aksidente të ndryshme, fatkeqësi natyrore, si dhe në ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

Aktiviteti i drejtorise për pjesën operacionale kryhet mbështetur në Ligjin Nr.152/2015 Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”, dhe për pjesën administrative në Kodin e Punës si edhe aktet ligjore në fuqi që rregullojnë mënyrën e funksionimit të saj.

-Gjatë kryerjes së auditimit nga grupi i auditimit është synuar një vlerësim në tërësi i sistemit në përputhje në udhëzimet dhe metodikat e miratuara me qëllim që, sistemet e menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe performanca e njësive të audituar të jenë transparente dhe në përputhje me normat e ligjshmërisë, rregullshmërisë, dobisë, frytshmërisë dhe kursimit.

-Janë diskutuar në takim me fillestar me ish drejtorin e komanduar z. Ervin Hoxhallari dhe ekonomistin e drejtorise z. Altin Bojaxhiu dhe punonjes të tjerë objektivat, formati, metoda e auditimit, linjat e komunikimit, aksesit në TI dhe afatet për raportimet.

Gjatë auditimit janë rishikuar dhe vlerësuar dokumentacioni i mëposhtëm:

1. Ngritja, miratimi dhe funksionimi i strukture organizative.
2. Rregullorja, planet vjetore e mujore, programet e punës, analiza sipas sektoreve dhe çdo dokument tjetër që ka të bëjë me zhvillimin e veprimtarisë.
3. Dokumentacioni i prokurimit të fondeve dhe investimeve nëse ka.
4. Dokumentacioni i ndjekjes së normativave të shpenzimeve dhe të ardhurave;
5. Administrimi i vlerave monetare dhe materiale

- Janë realizuar të gjitha pikat e programit sipas tematikës të miratuar nga përgjegjësi i grupit.

- Pasi ka përfunduar puna në terren janë diskutuar gjetjet e auditimit me stafin e drejtorise dhe është rënë dakort për çështjet e trajtuara.

II. METODA E AUDITIMIT

Percaktimi i procedurave të auditimit nga grupi i auditimit u bë duke patur parasysh parimet themelore të auditimit si më poshtë:

Procedurat e auditimit kanë për qëllim të sigurojnë evidence të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme të cilat do të përbëjnë një bazë të arësyeshme për vlerësimin dhe përfundimet e auditimit.

1. Kontrolli aritmetik

Duke e konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston ne thelb ne regjistrimin e fakteve ne një forme numerike, si dhe ne paraqitjen sintetike te tyre, por midis rregjistrimit fillestar te fakteve dhe paraqitjes ne forme sintetike, që janë dhe qellimi I tij, behen nje seri veprimeshqe kane te bejne me evidentimin ne llogari.

Kontrolli aritmetik u krye me qellim qe te sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogarite perkatese, perfundojne me nxjerjen e gjendjes sintetike.

2.Kontrolli me ane te pjeseve justifikuese.

Kontrolli me zgjedhje I pjeseve justifikuese konstatoi nese shifrat e kaluara kane patur justifikim te mjaftueshem dokumentar.UMF nr 30,dt 27.12.2011” Mbi menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik”.

3.Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoj ne ekzaminimin e letrave me vlere (kontrollin faktik te akteve te gjobave sipas numrave serial), kontrolli I gjendjes se blloqeve te letrave me vlere sipas numrave serial te terhequr, dhe ekzaminoj perputhjen nepermjet pasqyrimin te akt detyrimeve dhe te ardhurave me blloqet e akteve te kontrollit dhe te gjobave, duke siguruar ekzistencen reale te ketyre aktiveve ne subjekt.

Për kryerjen e auditimit dhe arritjen e objektivave të përcaktuara jemi bazuar ne metodën e kombinimit të pyetësorëve për funksionimin e kontrollit të brendshëm sipas sistemeve e fushave të llogarisë.

I. Zbatimi i rekomandimeve te lena nga auditimi i meparshem.

Ne zbatim te Rekomandimeve te Sektorit te auditimit te brendshem te Bashkise Berat derguar Drejtorise se MZSH se me shkresen nr 182/1 prot , date 09.04.2018 nga Drejtoria e MZSH-se eshte hartuar Plani i Veprimit ku jane pranuar te 18 rekomandimet e adresuara.

Jane zbatuar gjithsej 13 rekomandime dhe ne proces jane 5 rekomandime.

Zbatimi i rekomandimeve i detajuar paraqitet si me poshte:

Rekomandimi nr 1: Drejtoria e MZSH-se te marre ne konsiderate rekomandimet e lena nga grupi yne i auditit dhe rekomandimet e lena nga grupi i auditit te Ministrise se Brendshme per periudhen e audituar 2014-2015 , kur kjo drejtori ka qene ne varesi te Institucionit te Prefektit te Qarkut Berat;

1.1 Nga verifikimi rezultoi: Drejtoria e MZSH-se ka marre ne konsiderate rekomandimet e lena nga grupi yne i auditit dhe rekomandimet e lena nga grupi i auditit te Ministrise se Brendshme per periudhen e audituar 2014-2015, kur kjo drejtori ka qene ne varesi te Institucionit te Prefektit te Qarkut Berat;

- Zbatuar

Rekomandimi nr 2: Nga ekonomisti i drejtorise te MZSH-se ne bashkepunim me specialistin e buxhetit te bashkise te ndiqet ne cdo hap planifikimi, hartimi dhe zbatimi i buxhetit te Drejtorise se MZSH-se;

2.1 Nga verifikimi rezultoi: planifikimi, hartimi dhe zbatimi i buxhetit te Drejtorise se MZSH-se eshte ndjekur nga ekonomisti i drejtorise te MZSH-se ne bashkepunim me specialistin e buxhetit te bashkise.

- Zbatuar

Rekomandimi nr 3: Te rregjistrohet plani i shpenzimeve i detajuar dhe te ndiqet situacioni plan- fakt sipas zerave periodikisht, ne menyre qe te lehtesoje rakordinin ne kohe dhe me eficence te punes me degen e thesarit dhe sektorin e buxhetit te bashkise.

3.1 Nga verifikimi rezultoi: Plani i shpenzimeve eshte detajuar dhe ndjekja e situacionit plan- fakt sipas zerave periodikisht, ndiqet nga ekonomisti dhe specialistja e buxhetit me rakordinin me degen e thesarit dhe sektorin e buxhetit te bashkise.

-Zbatuar

Rekomandimi nr 4: Te analizohen shkaqet dhe te dalin pergjegjesite ne rastet e mosrealizmit te zerave buxhetore dhe akumulimin e detyrimeve te prapambetura.

4.1 *Nga verifikimi rezultoi:* Pergjithesisht jane analizuar shkaqet e mosrealizimit te zerave buxhetore dhe jane ndjekur debitoret sipas veprimeve te perseritura per kerkese per arketim.

- Ne proces.

Rekomandimi nr 5: Te gjenden menyra dhe mjetet ligjore per t'i dhene prioritet rritjes se investimeve ne krahasim me rritjen e fondit të pagave dhe shpenzimeve operative;

5.1 *Nga verifikimi rezultoi:* Ka permiresim ne dhenien e prioritetit te investimeve kryesisht te nderteses se MZSH-se dhe mjeteve te reja nga fondi i Ambasades Japoneze dhe donatorë te ndryshem per paisje me mjete zjarrefikese.

- Realizuar

Rekomandimi nr 6: Te ndiqen te gjitha procedurat ligjore per realizimin e programit buxhetor ne zerin 602 nepermjet punes se programuar per arritjen e objektivave te vendosura;

6.1 *Nga verifikimi rezultoi:* Programi buxhetor ne zerin 602 eshte zberthyer ne menyre analitike, por realizimi le per te dëshiruar pasi kerketat tona per disa artikuj ndonese ka patur buxhet nuk jane realizuar nga bashkia.

- Ne proces

Rekomandimi nr 7: Drejtori i MZSH-se Berat ne baze te nenit nr 10 te ligjit nr 152, date 21.12.2015 “ Per sherbimin e mbrojtjes nga shpetimin” t'i kerkoje Drejtorise se Pergjithshme te MZSH-se qe te hartoj rregullore per mbrojtjen nga zjarri dhe shpetimin, ne perputhje me ligjin specifik, e cila te miratohet me VKM;

7.1 *Nga verifikimi rezultoi:* Eshte miratuar rregullorja Tip“ Per miratimin e Rregullores për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpetimin”, me VKM nr 520, date 25.07.2019.

- Zbatuar

Rekomandimi nr 8:

Te merren te gjitha masat ligjore per plotesimin e dosjeve te mjeteve motorike me dokumentacion te plote dhe te gjenden te gjitha menytrat per sigurimin dhe kolaudimin e tyre;

8.1 *Nga verifikimi rezultoi:* Eshte kerkuar Drejtorise se Rrugeve dhe Transporteve me shkresen nr 1499, date 21.03.2018, per plotesimin e dosjeve te mjeteve motorike dhe plotesimin me dokumentacion te plote per sigurimin dhe kolaudimin e tyre.

-Ne proces

Rekomandimi nr 9:

Te pasqyrohet sakte dhe pa gabime regjistrimi dhe kontabilizimi i dokumentave vertetues (flete hyrje, flete dalje) dhe menjehere pasi eshte kryer veprimi ekonomik (udhezimi nr 30 pika 35-60) ;

9.1 *Nga verifikimi rezultoi:* Flete hyrjet e flete daljet jane shoqeruar ne kohe sipas radhes kronologjike dhe pa gabime.

- Zbatuar

Rekomandimi nr 10:

Te kryhet me pergjegjesi dhe ne perputhje me rregullat e prokurimit elektronik planifikimi dhe hartimi i fondit limit si edhe te argumentohet ky fond mbeshtetur ne te gjitha nevojat e drejtorise se MZSH-se;

10.1 *Nga verifikimi rezultoi:* Drejtoria e MZSH-se eshte me bilanc nga Bashkia Berat dhe regjistri i planifikimit dhe realizimit te prokurimeve ndiqet nga drejtoria e finances se Bashkise Berat dhe drejtoria e prokurimeve publike.

-Zbatuar

Rekomandimi nr 11: Per te shmangur parregullesite dhe gabimet ne te ardhmen planifikimi per zerin karburant te kryhet edhe mbi plane te menaxhimit te situatave te emergjences qe shoqerohen me masa konkrete te drejtorise se MZSH –se.

11.1 Nga verifikimi rezultoi: Planifikimi per zerin karburant eshte ndjekur me kerkesa zyrtare sipas nevojave. Per menaxhimin e situatave te emergjencave te krijuara eshte shoqëeruar me masa konkrete nga Drejtoria e MZSH-se.
-Zbatuar

Rekomandimi nr 12: Te monitohet procesi i administrimit dhe levizjes se aktiveve qarkulluese nepermjet rregullave te qarta dhe kontroleve periodike me synimin qe t'i sherbejne zbatimit te rregullave te miremenaxhimit financiar;

12.1 Nga verifikimi rezultoi: Ndonese ka nje permiresim ne evidentimin e kontroleve periodike perseri ka vend per permiresimin, sidomos ne evidentimin e te ardhurave.

- Ne proces

Rekomandimi nr 13: Te mbahet nje data base i dokumentuar dhe elektronik per rregjistrimin e te ardhurave te krijuara nga institucioni, te kryhet rakordimi tyre dhe te raportohet nepermjet evidencave periodike realizimi i tyre;

13.1 Nga verifikimi rezultoi: Ne bashkepunim me specialisten e te ardhurave te bashkise evidentohet me data base dhe elektronik i te ardhurave te krijuara nga institucioni dhe raportohet nepermjet evidencave periodike per realizimin e tyre.

- Ne proces

Rekomandimi nr 14: Te ardhurat e realizuara per sherbimet e ofruara nga MZSH-ja te arketohen ne favor te buxhetit te bashkise ne zbatim te VKM Nr.285, Date 27.06.2002 "Per tarifat e sherbimeve qe kryen PMNZSH ndaj shtetasve dhe personave juridike e fizike, vendas te huaj",Pika 6,7;

14.1 Nga verifikimi rezultoi:Te ardhurat qe realizohen nga arketimi i pageses se ketyre tarifave derdhen ne nivelin vendor dhe per llogari te Ministrisë se Brendshme te destinuara per veprimtarine e sherbimit te MZSH-ve.

- Realizuar

Rekomandimi nr 15: Te zhdemtohet shuma 10'000 leke nga aplikuesit per leje z. Shkelqim Bendo dhe z.Levent Peshtanaku te cilet nuk kane kryer pagesen e tarifes se miratuar per projektin e mbrojtjes nga zjarri si rezultat i mosveprimit te punonjesit te autorizuar per kunderfimimin ne sistem;

15.1 Nga verifikimi rezultoi: Eshte zhdemtuar në masë të plotë shuma 10'000 leke nga aplikuesit per leje z. Shkelqim Bendo dhe z.Levent Peshtanaku te cilet nuk kane kryer pagesen e tarifes se miratuar per projektin e mbrojtjes nga zjarri.

- Realizuar

Rekomandimi nr 16: Te mbahen evidenca mujore dhe progresive e debitoreve dhe te raportohen ne zyren e finances se bashkise per kryer veprimet e kontabilitetit;

16.1 Nga verifikimi rezultoi: Eshte mbajtur evidence progresive e debitoreve dhe eshte raportuar ne fund të cdo viti gjendja e debitoreve e cila me 31 Dhjetor 2021 eshte në shumen 1.775.000 lekë, nga te cilat detyrimet nga Prefektura Berat jane ne shumen 1.725.000 leke.

- Ne proces

Rekomandimi nr 17: Vlera prej 2'281'000 te kontabilizohet si vlere debitore dhe te merren te gjitha masat ligjore per arketimin e saj;

17.1 Nga verifikimi rezultoi: Eshte arketuar vlera 2.281.000 nga Prokuroria e Rrethit Berat per akt ekspertizat e kryera nga Inspektoret e MZSH-se.

- Zbatuar

Rekomandimi nr 18: Te krijohet dhe administrohet rregjistri i aktiveve i cili duhet te perfshije aktivet afatgjata aktivet afatshkurtra materiale e monetare dhe aktivet te cilat jane ne pronesi te njesise ne perputhje me Udhezimin nr. 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik", pika 26 – 28 ;

18.1 Nga verifikimi rezultoi : Ështe krijuar rregjistri i aktiveve afatshkurtera, aktiveve afatgjata, ne perputhje me Udhezimin nr. 30 date 27.12.2011 "Per menaxhimin e aktiveve ne njesite e sektorit publik", pika 26 – 28 ;

- Realizuar

II. Sistemi i programimit dhe zbatimit të buxhetit.

Në hartimin e buxhetit për vitet 2018 - 2021 per Drejtorine e MZSH-se, si baze ligjore kane sherbyer procedurat e përcaktuara në Ligjin Nr.9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” te ndryshuar, Buxheti sipas viteve te auditimit është vendimuar me VKB-të përkatëse të cdo viti buxhetor, të pasuruara me ndryshimet gjatë vitit buxhetor në zbatim të Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore”. Vendimet e Këshillit Bashkiak për cdo vit buxhetor si me poshtë:

Per vitin 2018:

-VKB nr. 98 datë 15.12.2017 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2018 dhe PBA përfundimtare 2018 - 2020”, i ndyshuar gjatë vitit;

Per Vitin 2019:

-VKB nr. 140 datë 07.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2019 dhe PBA përfundimtare 2019 - 2021”, i ndyshuar .

Per Vitin 2020:

-VKB nr. 66 datë 26.12.2019 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2020 dhe PBA përfundimtare 2020 - 2022”;

Per Vitin 2021:

-VKB nr. 81 datë 29.12.2020 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Berat për vitin 2021 dhe PBA përfundimtare 2021 - 2023”;

Konstatohet se buxheti per periudhen e auditimit ka rritje nga viti ne vite, gje qe tregon perkujdesje dhe ne rritje cilesore te sherbimit e shprehur kjo ne investimet si per ndertesat e MZSH-se dhe në paisje me mjete të reja bashkekohore dhe me mjete zjarrfikese per te nderhyre ne lagjet muzeale.

Konkretisht realizimi plan- fakt, sipas artikujve reflektohet edhe ne situacionet e leshuara nga rakordimi me degen e thesarit per periudhen e auditimit, si me poshtë:

Ne 000/leke

Artikull.	Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020		Viti 2021	
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
600	27,794	22,572	28,226	25,954	29,913	22,645	26,730	23,100
601	4,421	3,738	4,672	4,349	4,946	3,750	4,420	3,853
602	3,739	3,278	4,506	2,292	9,532	3,660	8,972	4,461
606	0	0	0	68			8,135	4,635
231	0	0	0	0	1,696	1,696	43,463	13,868
Totali	34,954	29,588	37,404	32,663	46,087	31,751	91,720	49,917

Nga analiza e zerave te shpenzimeve per vitet 2018 dhe 2019, vihet re se pjesen me te madhe te shpenzimeve e zene shpenzimet per paga dhe sigurime shoqerore ne masen rreth 88 % te planit te shpenzimeve ne total, ndersa shpenzimet operative zene rreth 10 % te shpenzimeve te pergjithëshme. Realizimi i planit ne total per vitin 2018 eshte ne masen 84.7%. Realizimi i planit ne total per vitin 2019 eshte ne masen 87.3% dhe per vitin 2020 realizimi eshte ne masen 69%.

Per vitin 2021 jane programuar investime nga ana e bashkise per riparimin e godines se MZSh-se dhe per blerje autozjarrfikese te re.

Per vitet 2020 dhe v. 2021 ka permiresim te buxhetit duke i dhene perparesi rritjes se investimeve ne krahasim me rritjen e pagave .

Konkretisht realizimi sipas zerave buxhetore paraqitet si me poshte:

Per vitin 2020 shpenzimet per paga e sig shoqerore zene 76% te realizimit te buxhetit, cka deshmon ne programimin jo real qe vjene dhe nga mos plotesimi i struktures nga 38 punonjes te programuar, faktike jane 34 punonjes.

Per vitin 2021 shpenzimet per paga e sig shoqerore zene 54% te realizimit te buxhetit total te ketij viti , realizimi i investimit ze 27.8%, kurse realizimi i pagave e sig. shoqerore eshte ne masen 86.5 %, qe vjene dhe nga mos plotesimi i struktures nga ana e bashkise.

Realizimi analitik i shpenzimeve operative te programit 03280 sipas artikujve te programuar dhe realizuar per periudhen 01.01.2021-31.01.2021 paraqitet si me poshte:

Ne(000) leke

Nr	Llog. Ekonom	Emertimi	Plani Fillestar 2021	Plan Korrigj Vjetor	Realizimi Faktik	% Realiz.
1	6020	Materiale zyre dhe te pergjithshme	50	50	0	0
1/1	6020	6020 Kancelari 100	50	50	0	0
2	6021	Materiale dhe sherbime Speciale	570	2,020	1,361	67.4
2/1	6021	6021 Uniforma 001	320	520	0	0
2/2	6021	6021 Pajisje speciale 099	250	1,500	1,361	91
3	6022	Sherbime nga te tretet	800	1,250	944	76
3/1	6022	6022 Energji 001	470	470	714	151
3/2	6022	6022 Uje 002	300	750	211	28
3/3	6022	6022 Te tjera sherbime 099	30	30	19	63
4	6023	Shpenzime Transporti	2,150	3,750	2,149	57
4/1	6023	6023 Karburant dhe vaj 100	1,570	2,270	1,207	53
4/2	6023	6023 Pjese kembimi,goma,bateri 200	500	1,200	751	63
4/3	6023	6023 Spenz. siguracion I mjeteve transportit 300	80	280	192	69
5	6029	6029 Te tjera mallra dhe sherbime 009	0	1,902	7	0.4
		Totali	3,570	8,972	4.461	50

Per vitin 2018 realizimi i shpenzimeve operative eshte ne masen 87.7%, per vitin 2019 realizimi i shpenzimeve operative është ne masen 51 % per vitin 2020 realizimi i zerit 602, shpenzime operative eshte ne masen 38.4%. Per sa i perket shpenzimeve te tjera ato zene nje peshe prej rreth 10% ku shpenzimet per karburant zene pjesen me te madhe duke qene se sherbimi i mbrojtjes nga zjarri kryhet me 7 mjete dhe 2 motopompa.

Per vitin 2021, per artikullin 602 ka nje realizim ne masen 50% . Mosrealimi prej 50% nuk eshte i argumentuar nderkohe qe drejtoria ka mangesi ne plotesimin e nevojave per kancelari, materiale veshmbathje e speciale. I pyetur per aresyen e mosrealizimit te treguesve te programimit ekonomisti argumenton se kemi bere kerkesa ne bashki, por nuk jane zbatuar.

Banka dhe situacionet mujore te shpenzimeve jane te ndjekura sipas artikujve ne total te 600,601,602 nga specialistja e buxhetit te bashkise por nevojitet qe plan/fakti i shpenzimeve per artikullin 602 te detajohen dhe ndiqet ne menyre analitike, ne menyre qe MZSH te jete ne cdo kohe e informuar per fondet qe disponon dhe perdor .

III. Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore, i pagave e shtesat mbi page

Për periudhën e audituar në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi ka zhvilluar aktivitetin e saj në zbatim të Vendimit nr. 810 datë 31.10.2017 dhe Vendimit nr. 434 datë 07.07.2020 të kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e Strukturës së Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi të Bashkisë Berat”. Struktura aktuale është si më poshtë:

N r	Emertimi sipas strukture	Niveli	Katego ria	Nr. punonjesve	Arsimi i kerkuar
1	Drejtori i MZSH-se	Niveli Larte	Me grade	1	I larte policor/ushtarak/juridik/inxhinieri
2	Ekonomist	Funksion Administrativ	Kl III B	1	Ekonomist
3	Punonjes Protokoll- Arkive, Magazine	Funksion Administrativ	Kl III B	1	Arsimi Larte
Spektori i Inspektimit dhe Parandalimit					
1	Shef. Sek.Inspek.Parandalim	Niveli mesem	Me Grade	1	I Larte policor/ushtarak/juridik/inxhinieri
2	Inspektor /Parandalimi	Nivel mesem	Me grade	2	I Larte policor/ushtarak/juridik/inxhinieri
3	Inspekt. Stervitje	Nivel baze	Me grade	1	Arsimi i mesem
Spektori Per Shuarjen e Zjarrit dhe Shpetimin					
1	Shef i Sektorit te Shuarjes se Zjarrit dhe te nderhyrjeve	Niveli mesem	Me Grade	1	I Larte policor/ushtarak/juridik/inxhinieri
2	Komandant Sherbimi	Niveli baze	Me grade	4	Arsimi i mesem
2	Punonjes ne sallën operuese	Niveli baze	Me grade	4	Arsimi i mesem
3	Luftues, shpetues, drejtues automjeti	Niveli baze	Me grade	21	Arsimi i mesem
4	Luftues, shpetues, drejtues automjeti, mekanik	Niveli baze	Me grade	1	Arsimi i mesem
Totali				38	

Në listëpagesën e fundit të periudhës së audituar Dhjetor 2021, për sektorin e Mzsh-së janë në listëprezence 34 punonjës që do të thotë se janë vakantë 4 pozicione pune, përkatësisht:

1-Drejtori i MZSH-së, pozicion të cilin e mban me Urdhërin nr. 479 date 27.06.2019 si Drejtor i Komanduar, z. Ervin Hoxhallari me detyrë Inspektor në Sektorin e Parandalimit;

2-Shef i Sektorit të Parandalimit;

3- 2 (dy) punonjës në pozicionin “Luftues, shpëtues drejtues automjeti”;

Auditi ka marrë me përzgjedhje periudhën e auditimit për elementet e pagës të cdo punonjësi të strukturës. Llogaritja e pagës është kryer mbështetur në:

- 1- Vkm nr. 895 datë 21.12.2016 “Për kriteret e ecurisë së fitimit të gradave, njësimit e funksioneve korresponduese për cdo grade, paraqitjen, formën dhe specifikimet teknike të gradave të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi” që specifikon elementin e gradave të punonjësve dhe mënyrën e përfutimit të saj;
- 2- Vkm nr. 350 datë 19.04.2017 “Për trajtimin me pagë dhe shtesat mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” që përcakton pagën bazë për gradë dhe shtesat për natyrë të vecantë pune;
- 3- Vkm nr. 203 datë 10.04.2019 “Për përcaktimin e kriterëve, të masës së përfitimit dhe llojeve të pushimeve të tjera, me apo pa pagesë, në shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, që përcakton llogaritjen e orëve shtesë të punës;

Për elementet e pagës “paga baze per grade”, “shtesa për natyrë të vecantë pune”, dhe “vjetërsia” u panë 24 listepagesa të periudhës 2020 dhe 2021. Procedura e fundit e ndjekur nga MZSH-ja për gradimin e punonjësve është e vitit 2017, ku për secilin punonjës është dhënë grada përkatëse me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të Drejtorisë së PMNZSH-së. Paga për këta elementë në listëpagesat e vitit 2020 dhe 2021 është kryer korrektësisht në zbatim të Vkm-së nr. 350 datë 19.04.2017. Për punonjësit e rinj që janë shtuar në strukturën e drejtorisë, për periudhën e audituar, nuk është ndjekur procedura e dhënies së gradave në zbatim të Udhezimit nr. 211 date 03.04.2017 “Për përbërjen dhe funksionimin e komisioneve të vlerësimit të gradave”. Këta punonjës janë paguar në listë pagesë me nivelin bazë “Asistent zjarrfikës”, grade të cilën nuk e kanë përfituar për shkak të mungesës së procedurës që duhet të ishte kryer në zbatim të pikës 2 të nenit 24 të Ligjit nr. 152/2015 “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”. Vazhdimësia e pagesës në këtë formë sjellë 2 (dy) anomalitë:

- 1- Pagesën e punonjësit i cili është pjesë e strukturës së MZSH-së e cila përcakton me gradën dhe rrjedhimisht pagesa kryhet në bazë të gradës së përfituar në zbatim të nenit 31, pika 1 gërma a) të Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”;
- 2- Mos gradimi në kohën e duhur të punonjësve është penalizuese për karrierën e tyre në vazhdimësi dhe paga korresponduese për nivelin e gradës që secili meriton të përfitojë në zbatim të nenit 25 të Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” ;

Pagesa për elementin e pagës “vjetërsi”, për punonjësit e Mzsh-së kryhet mbështetur në pikën 3 të Vkm-së nr. 350 datë 19.04.2017 që shprehet: *“Punonjësit e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, për çdo vit vjetërsi shërbimi, përfitojnë shtesë mbi pagë, në masën 1 për qind për çdo vit, deri në 25 vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi vlerën e pagës bazë të gradës “Asistent zjarrfikës”. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi, në strukturat e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Forcave të Armatosura, Policisë së Burgjeve, Gardës së Republikës, Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat, si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.”* Nga auditimi i listepagesave u konstatua se punonjësi Dilaver Grëmshi për periudhën Tetor 2020 – Shkurt 2021 është paguar me 2 vjet vjetërsi pune dhe për periudhën Mars 2021 – Dhjetor 2021 është paguar për 3 vjet vjetërsi pune. Nga librezat e punës z. Dilaver Grëmshi rezultojnë 5 vite për pune për periudhën Tetor 2020 – Shkurt 2021 dhe 6 vite pune për periudhën Mars 2021 – Dhjetor 2021, pasi nuk ka gjurmë të shkeputjes së marrëdhënies së punës në këtë librezë por ka 2 (dy) herë fillim të pozicionit të punës. Llogaritja e vjetërsisë si më poshtë:

Viti	Muaji	Paguar	Duhet	Diferenca
2020	Tetor	364	909	545
	Nentor	800	2,000	1,200
	Dhjetor	800	2,000	1,200
2021	Janar	800	2,000	1,200
	Shkurt	800	2,000	1,200
	Mars	1,200	2,400	1,200
	Prill	1,200	2,400	1,200
	Maj	1,200	2,400	1,200
	Qershor	1,200	2,400	1,200
	Korrik	1,200	2,400	1,200
	Gusht	1,200	2,400	1,200
	Shtator	1,200	2,400	1,200
	Tetor	1,200	2,400	1,200
	Nentor	1,200	2,400	1,200
	Dhjetor	1,200	2,400	1,200
Totali				17,345

Për elementin “shtesë page për orët shtesë”, u auditua periudha Prill – Qershor 2021, në zbatim të Vkm-së 203 datë 10.04.2019. Pagesat nga MZSH-ja për këtë element kanë filluar që nga muaji Prill 2021 dhe kanë vazhduar në vijimësi. Dokumentimi i orëve shtesë bëhej në ‘Listen e gadishmërisë’ ku përcaktohej emri i punonjësit, ora e njoftimit, ora e paraqitjes dhe orët që ka qëndruar në gadishmëri. Ky dokument firmosej nga komandanti i shërbimit dhe nga zyra e informacionit. Audit i administroi listat e gadishmërisë për periudhën Prill-Qershor 2021, listë prezencën e MZSH-së për këtë periudhë, llogaritjen e kryer për periudhën dhe rezultate si më poshtë:

N r.	Emer Mbiemer	Dite te zakonshme/25% per cdo ore pune	Dite pushim javor/50% per cdo ore dite pushimi javor	Nderhyrje operacionale nga ora 22-06/50% per cdo ore une	Dite te zakonshme	Paga orare	Paga/Dite pushim javor	Paga/Nderhyrje operacionale nga ora 22-06	Paga/Dite te zakonshme	Paga total/ore sipas listes se gadishmerise	Paguar	Diferenca
1	Arnold Karkanjozi	37.5	4.5	8	29.5	279	1,885	3,352	10,300	15,537	12,744	2,793
2	Artan Merko	4	20.5		4	466	14,315	-	2,328	16,642	16,526	117
3	Artan Sulejmani	36.5	7	8	28.5	340	3,572	4,083	12,121	19,776	17,065	2,710
4	Aselito Filaj	35	0	8	27	279	-	3,352	9,427	12,778	14,035	(1,257)
5	Avenir Mino	29	7	8	21	344	3,612	4,128	9,029	16,768	17,617	(849)
6	Bashkim Hajrullaj	33.5	13	8	25.5	286	5,581	3,434	9,123	18,138	14,238	3,900
7	Bastrit Hoxha	38.5	12	8	30.5	379	6,828	4,552	14,461	25,841	22,569	3,272
8	Dajlan Keli	36	2.5	8	28	286	1,073	3,434	10,017	14,525	15,169	(644)
9	Damian Xhaferaj	24	7	8	16	275	2,884	3,297	5,494	11,675	11,675	0
10	Diuis Nepravishta	47.5	0	8	39.5	286	-	3,434	14,131	17,566	15,669	1,896
11	Edison Haderi	17	14	8	9	275	5,769	3,297	3,091	12,156	11,538	618
12	Enkled Marra	36.5	9.5	8	28.5	275	3,915	3,297	9,787	16,998	14,251	2,747
13	Eno Kule	29	14	16	13	286	6,010	6,869	4,651	17,530	17,744	(214)
14	Erald Dervishi	15	2.5		15	275	1,030	-	5,151	6,181	7,486	(1,305)
15	Erlin Çifliku	33	14	16	17	286	6,010	6,869	6,082	18,961	18,317	645
16	Ervin Hoxhallari	0	15.5		0	366	8,498	-	-	8,498	8,224	274
17	Fredi Metollari	0	4.5		0	379	2,560	-	-	2,560	2,276	284
18	Gazmend Poçi	29	12	8	21	352	6,331	4,221	9,233	19,784	19,960	(176)
19	Gazmir Zylali	38.5	12	8	30.5	286	5,152	3,435	10,912	19,498	17,029	2,469
20	Gentjan Vreko	36.5	2.5	8	28.5	368	1,379	4,414	13,103	18,896	15,218	3,678
21	Gerald Nasufi	32	14	16	16	270	5,672	6,483	5,402	17,557	16,949	608
22	Indrit Mehmeti	38.5	12	8	30.5	279	5,028	3,352	10,649	19,028	16,619	2,409
23	Kevin Hija	37	2.5	8	29	272	1,022	3,269	9,875	14,165	15,868	(1,703)
24	Klevis Agalliu	27	7	8	19	279	2,933	3,352	6,634	12,918	12,918	(0)
25	Kriton Kreku	38	2.5	8	30	284	1,065	3,407	10,646	15,118	15,331	(213)

26	Ledion Shtembari	38.5	5	8	30.5	279	2,095	3,352	10,649	16,095	13,686	2,409
27	Robert Spahiu	17	0		17	286	-	-	6,082	6,082	6,082	0
28	Saimir Toska	35	0	8	27	326	-	3,917	11,017	14,934	14,934	0
29	Vullnet Nazëraj	16	0		16	368	-	-	7,356	7,356	7,356	-

Gjetje:

1. Për punonjësit e rinj që janë shtuar në strukturën e drejtorisë, pas vitit 2017, nuk është ndjekur procedura e dhënies së gradava. Këta punonjës janë paguar në listë pagesë me nivelin bazë “Asistent zjarrëfikës”, pa e përfituar këtë gradë;
2. Për elementin e pagës “shtesë page për orët shtesë” ka diferenca në pagën bruto për 24 (njëzetë e katër) punonjës. Për elementin e pagës “vjetërsi”, ka diferenca në pagën bruto për 1 (një) punonjës;

Rekomandime:

1. MZSH-ja në zbatim të pikës 2 të nenit 24 të Ligjit nr. 152/2015, Udhëzimit nr. 211 datë 03.04.2017, të marrë masat e duhura për gradimin në kohë të punonjesve aktuale dhe të rinj të emëruar në strukturën e vet;
2. Nga personat përgjegjes për hartimin e listëpagesës së MZSH-së të bëhen veprimet korrektuese për 24 (njëzetë e katër) punonjës të gjetur me gabime, ne vleren 30,830 leke per 16 persona paguar me pak dhe -6,359 leke per 8 persona paguar teper në veprim dhe per 1 (nje) person ne vlerën 17,345 (shtatëmbëdhjetë mijë e treqindëdyzetë pesë) lekë paguar me pak;

Gjetja nr. 1: Për punonjësit e rinj që janë shtuar në strukturën e drejtorisë, pas vitit 2017, nuk është ndjekur procedura e dhënies së gradava. Këta punonjës janë paguar në listë pagesë me nivelin bazë “Asistent zjarrëfikës”, pa e përfituar këtë gradë;	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligjit nr. 152/2015, Udhëzimit nr. 211 datë 03.04.2017
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Për punonjësit e rinj që janë shtuar në strukturën e drejtorisë, pas vitit 2017, nuk është ndjekur procedura e dhënies së gradava.
	Kriteri: Ligjit nr. 152/2015, Udhëzimit nr. 211 datë 03.04.2017
	Ndikimi/Efekti: Këta punonjës janë paguar në listë pagesë me nivelin bazë “Asistent zjarrëfikës”, pa e përfituar këtë gradë
	Shkaku: Mos kryerja e procedurës së gradimit
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë
Konkluzioni	
Rekomandimi	MZSH-ja në zbatim të pikës 2 të nenit 24 të Ligjit nr. 152/2015, Udhëzimit nr. 211 datë 03.04.2017, të marrë masat e duhura për gradimin në kohë të punonjesve aktuale dhe të rinj të emëruar në strukturën e vet;

Gjetja nr. 2: Për elementin e pagës “shtesë page për orët shtesë” ka diferenca në pagën bruto për 24 (njëzetë e katër) punonjës. Për elementin e pagës “vjetërsi”, ka diferenca në pagën bruto për 1 (një) punonjës;	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
Përmbledhja e bazës ligjore	Ligjit nr. 152/2015, Vkm-së 203 datë 10.04.2019, Vkm-së nr. 350 datë 19.04.2017

Përshkrimi i gjetjes	Situata: Diferenca në pagën bruto për disa punonjës
	Kriteri: Ligji nr. 152/2015, Vkm-së 203 datë 10.04.2019, Vkm-së nr. 350 datë 19.04.2017
	Ndikimi/Efekti: Pagesa jo korrekte sipas legjislacionit të pagave
	Shkaku:
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	<i>Risk i mesëm</i>
Konkluzioni	
Rekomandimi	<i>Nga personat përgjegjës për hartimin e listëpagesës së MZSH-së të bëhen veprimet korrektuese për 24 (njetë e katër) punonjës të gjetur me gabime, në vlerën 30,830 leke për 16 persona paguar me pak dhe 6,359 leke për 8 persona paguar tepër në veprim dhe për 1 (një) person në vlerën 17,345 (shtatëmbëdhjetë mijë e treqindëdyzetë pesë) lekë paguar me pak;</i>

Sektori i Inspektimit dhe Parandalimit

Për periudhën e audituar ky sektor ka pasur lëvizshmëri të personelit në strukturën e vet duke shkaktuar edhe vështirësi në gjetjen e dokumentacionit për kontrollin dhe inspektimet e kryera. Nga auditimi i dokumentacionit të këtij sektori u pa se situata dokumentare ka ndryshime shumë të vogla nga auditimi i fundit i kryer nga Bashkia Berat. Planin e punës mujore dhe vjetore janë shumë të përgjithshme në formulimin e tyre, duke mos specifikuar cilat objekte do të auditohen në zbatim të rrezikshmërisë së tyre të specifikuar në kreun i të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020 “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, si dhe dhënia e Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri”. Nga regjistri i akteve të kontrollit për periudhën 2018 – 2021, janë kryer 244 akte kontrolli nga të cilat nuk është vërejtur asnjë masë administrative për mospërbushje të rregullave teknike të mbrojtjes nga zjarri. Janë plotësuar vetëm blloqet e akteve të kontrollit dhe vetëm 2 fletë të bllokut të akteve të inspektimit të dokumentacionit të bërë hyrje në datë 26.05.2021. Për blloqet e mëparshme nuk mund të gjendet tërësia e tyre pasi hyrja e parafundit ka qënë me datë 20.02.2017 dhe u verifikuan nga auditimi vetëm blloqet e gjobave (letra me vlerë).

Nga kqyrja e dokumentacionit të fletë hyrjeve dhe fletë daljeve të magazinës në lidhje me dokumentacionin (blloqet) e nevojshme për zhvillimin e punës së këtij sektori u vërejt se janë bërë hyrje në vitin 2027 dhe 2021 dhe nga magazinieri në detyrë është gjykuar ti behet dalje e gjithë sasia inspektorit në detyrë. Për vitin 2017, me fletë hyrjen nr. 6 datë 20.02.2017 dhe me fletë daljen me nr. extra pa datë e firmosur nga znj. Rudina Devole me detyrë magazinierë dhe znj. Mimoza Xhani me detyrë inspektore janë marrë në ngarkim dokumentacioni si më poshtë pa specifikuar numrat serial për secilin bllok:

Nr.	Emërtimi	Njësia	Sasia
1	Proces verbal konstatimi shkelje (gjoba)	bllok	2
2	Akt Bllokimi	bllok	2
3	Akt Kontrolli	bllok	10
4	Akt pezullimi	bllok	2
5	Akt inspektimi	bllok	5
6	Proces verbal inspektimi	bllok	2
7	K.V.P Konstatim shkelje (gjoba)	bllok	2

Për blloqet të cilat ka në ngarkim znj. Mimoza Xhani, me fletë daljen me nr. extra pa datë, nuk u gjend gjurmë dokumentacioni në vijimësi të dorëzimit të tyre në përfundim të detyrës së znj. Mimoza Xhani. Gjatë periudhës së auditimit, znj. Mimoza Xhani erdhi dhe konstatoi gjendjen e blloqeve që gjenden në Mzsh dhe nuk vendosi në dispozicion të auditit dorëzimin shkresor të detyrës

dhe të blloqeve që kish në ngarkim, sikundër e pretendon verbalisht që ka kryer dorëzimin e tyre. Në tërësi dhe vecanërisht për blloqet e gjobave respektivisht, 2 (dy) blloqe “Proces verbal konstatimi shkelje” dhe 2(dy) blloqe “K.V.P Konstatim shkelje”, nga personeli aktual i Mzsh-se dhe nga znj. Mimoza Xhani u kërkuar në ambientet e Mzsh-se dhe u gjeten 3 blloqe në mungesë të njërit, si më poshtë:

Nr.	Emertimi	Blloqe sipas fletë daljes		Blloqe gjendje të MZSH		
		Njesia	Sasia	Njesia	Sasia	Nr. serial
1	Proces verbal konstatimi shkelje (gjoba)	bllok	2	bllok	1	0000001-0000030
2	K.V.P Konstatim shkelje (gjoba)	bllok	2	bllok	2	0000001-0000050

Blloku që mungon është “Proces verbal konstatim shkelje”, i cila është bllok gjobash ose letra me vlerë që duhet të ndiqen me përgjegjësi të plotë nga personi që e ka në ngarkim dhe nga financa të kryhet inventarizimi në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar pika 80: “*Percaktimi i gjendjes së vlerave monetare në arke dhe letrave me vlerë bëhet nga nepunesi zbatues me anë të inventarizimit fizik minimalisht një here në muaj*”. Drejtorja e financës ka shkarkuar nga magazina e saj totalin e blloqeve, të cilat janë bërë hyrje në magazinën e MZSh-së (duplikim magazine), dhe sërish janë bërë dalje në total inspektorit në detyrë, duke mos ndjekur vazhdimësinë e tyre, dhe duke ia transferuar ndjekjen e personit i cili e ka në ngarkim. Në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”, neni 50, vlera minimale e sanksioneve në plotësi të bllokut të gjobave është 5,000 lekë. Vlera e bllokut të humbur është 30flete*5,000 lekë/fleta=150,000 lekë në ngarkim të znj. Mimoza Xhani.

Flete hyrja e rradhës është me nr. 8 datë 26.05.2021 në të cilën janë specifikuar numrat seriale për të gjitha blloqet e bërë hyrje. Të gjitha blloqet i janë bërë dalje z. Dilaver Gremshi me detyrë funksionale inspektor parandalimi me nr. fletë dalje nr. 79 datë 01.07.2021 si më poshtë:

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Nr. serial
1	Autorizim inspektimi	bllok	5	0000001-0000150
2	Akt kontrolli	bllok	40	0000001-0001200
3	Akt pezullimi	bllok	5	0000001-0000150
4	P.V.Konstatim shkelje (Gjoba)	bllok	5	0000001-0000150
5	Akt bllokimi	bllok	5	0000001-0000150
6	Kontroll P.V.K.shkelje (gjoba)	bllok	5	0000001-0000125
7	P.V.Inspektimi	bllok	5	0000001-0000050

Për blloqet të cilat ka në ngarkim z. Dilaver Gremshi, auditi ka mbajtur një akt-verifikim për gjendjen fizike të tyre dhe nga kontrolli fizik rezultoi që janë përdorur vetëm blloqet e akt kontrolleve dhe është nisur vetëm 1(një) bllok inspektimi si më poshtë:

Nr.	Emertimi	Njesia	Bllok në përdorim/I përdorur		Blloqe bosh/te papërdorur	
			Sasia	Nr. serial	Sasia	Nr. serial
1	Autorizim inspektimi	bllok	1	0000001-0000030	4	0000031-0000150
2	Akt kontrolli	bllok	6	0000901-0001050,0001111-0001140	34	000001-0000900, 00015051-0001080,0001081-0001110, 0001141-0001200
3	Akt pezullimi	bllok	0		5	0000001-0000150
4	P.V.Konstatim shkelje (Gjoba)	bllok	0		5	0000001-0000150
5	Akt bllokimi	bllok	0		5	0000001-0000150
6	Kontroll P.V.K.shkelje (gjoba)	bllok	0		5	0000001-0000125
7	P.V.Inspektimi	bllok	0		5	0000001-0000050

Edhe në këtë rast punonjësi i magazinës ka gjykuar ti bëjë dalje të gjitha blloqet (ndër to edhe blloqet e gjobave) punonjësit të sektorit të parandalim inspektimit duke e lënë ndjekjen e tyre vetëm nga punonjësit që i ka marrë në dorëzim. Jo vetëm kaq por drejtorja e Mzsh-së ka rimarrë blloqe të ndryshme të dokumentacionit pa mbaruar ende blloqet e para të bëra hyrje në vitin 2017, të cilat një pjesë e konsiderueshme rezultojnë ende të paplotësuar.

Procedura e vlerësimit dhe miratimit e projektit të mbrojtjes nga zjarri

Procedura e vlerësimit dhe miratimit e projektit të mbrojtjes nga zjarri është e rregulluar me Vkm-në nr. 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit”, e ndryshuar, Udhëzimin nr. 81 datë 06.03.2020 “Për klasifikimin e objekteve, sipas rrezikshmërisë nga zjarri, procedurat e shqyrtimit dhe të miratimit të projektit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, si dhe dhënia e Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri”. Nga IT e bashkisë Berat, për auditin u administrua aksesimi në sistemin E-leje. Për periudhën 01.01.2018 – 31.12.2021 u filtruan të gjitha dosjet që i kanë ardhur drejtorisë së MZSH-së për vlerësim dhe miratim, nga punonjësi përkatës i Bashkisë Berat. Për periudhën e audituar janë trajtuar nga Mzsh 163 dosje që janë leje nderimi ose leje infrastrukturore, nga të cilat 20 leje janë refuzuar dhe 143 leje janë miratuar.

Udhëzimi nr. 81 datë 06.03.2020, kreu II përcakton gjithë procedurën që duhet të ndjekë Mzsh-ja për miratimin/pezullimin/refuzimin e lejeve të ndërtimit, të cilat kanë detyrimin ligjor të kenë projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi sipa llojit të rrezikshmërisë së objektit. Auditimi pa të gjitha lejet e ndërtimit të vitit 2021 (si viti i fundit i auditimit) dhe me përzgjedhje rastësore disa leje të periudhës 2018 – 2020 (tabelat tek kapitulli i të ardhurave). Si dokumentacion shkresor për miratimin dhe vlerësimin e lejeve të ndërtimit, MZSh-ja dispononte:

- 1- Cerifikatën e Sigurisë nga Zjarri;
- 2- Akt detyrimin e pagesës së tarifës së aplikimit të miratimit të projektit të mbrojtjes nga zjarri të lejes së ndërtimit;
- 3- Pagesën e tarifës nga qytetari

Nga kqyrja e dokumentacionit shkresor për miratimet e lejeve të ndërtimit me miratimin në sistemin e-leje, u konstatuan anomali në lidhje me zbatimin e udhëzimit për kryerjen e procedurës. Anomalitë e konstatuara nga auditimi janë:

1. Miratimi në sistemin e-leje nga drejtuesi i institucionit është shumë i cekët në formulimin e vet duke mos specifikuar të dhënat në zbatim të pikës 5 kreu II të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020, që shprehet: *“Shërbimi i MZSH-së, brenda 7 (shtatë) ditëve nga paraqitja e aplikimit për leje zhvillimi/ndërtimi, shqyrton: a) nëse subjekti legjitimohet për të paraqitur kërkesë; b) plotësimin e saktë të të gjitha të dhënave të detyrueshme, sipas formularëve nr. 1 dhe nr.1/1, “Vlerësimi i projektit të MZSH-së”, bashkëlidhur këtij udhëzimi dhe pjesë përbërëse të tij;c) paraqitjen e të gjitha dokumenteve (paraqitje grafike, relacioni teknik), të detyrueshme për miratimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;d) përputhshmërinë e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin me lejen e zhvillimit/ndërtimit, me planin e detajuar vendor, si dhe me normat teknike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin;e) dokumentacionin e projektuesit (ekspertit zjarrfikës), i cili duhet të përmbajë edhe deklaratën e përgjegjësisë mbi përputhshmërinë e projektit, me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri; f) nëse është kryer pagesa e tarifës për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin.”*. Nuk ka gjurmë në sistemin e-leje apo në dosjen shkresore sipas formulareve tip të udhëzimit, në të cilin inspektori i autorizuar në detyrë duhet të bëjë vlerësimin e projektit të paraqitur dhe a i plotëson kriteret ligjore për miratim. Miratimi nga titullari është kryer pa këtë vlerësim;

2-Në të gjitha rastet (lejet në analitik të trajtuara në kapitullin e të ardhurave), miratimi nga titullari është kryer para kryerjes së pagesës së tarifës për vlerësimin e projektit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin në kundërshtim me gërmën f, pika 5, kreu II të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020. Pagesa e tarifës nuk gjendet në sistemin e-leje por vetëm në mënyrë shkresore;

3-Certifikata e Sigurisë nga Zjarri, e gjendur në dosjen shkresore të akteve të pagesës është dokument që jepet **pasi** ka mbaruar procesi i lejës së ndërtimit dhe gjithë procedura e dhënies së saj

është e parashikuar në kreun III të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020, dhe jo sikundër ka vepruar MZSH që ka dhënë shkresërisht këtë certifikatë pa kryer procedurën;

4-Për vitin 2021, për të cilin u panë të gjitha lejet e ndërtimit, nga 24 leje ndërtimi janë miratuar në heshtje 11 prej tyre duke mos respektuar afatin 7 ditor të kthim përgjigje të përcaktuar në pikën 11 të kreut II të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020.

IV.Sistemi i realizimit, raportimit dhe ndjekjes se te ardhurave.

Drejtoria e Mzsh-së në zbatim të Ligjit nr. 152/2015 “Për shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin” neni 36 pika 2 kryen shërbime të ndryshme dhe për tarifimin e tyre për periudhën e auditimit gjen zbatim Vkm nr. 285 datë 26.06.2002 “Për tarifat e shërbimeve që kryen Policia e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin ndaj shtetasve dhe personave, juridikë e fizikë, vendas e të huaj” dhe Vkm nr. 607 date 29.07.2020 “Për tarifat për llojet e shërbimeve që ofrohen nga shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”. Auditimi u ndal tek të ardhurat që Mzsh-ja duhet të gjenerojë nga aplikimi në sistemin e-leje për projektin e mbrojtjes nga zjarri të lejeve të ndërtimit. U panë të gjitha lejet e vitit 2021 dhe me përzgjedhje rastësore disa leje për cdo vit të periudhës 2018 – 2020, për të monitoruar të gjithë procesin e detyrimit dhe arkëtimit të të ardhurave nga ky procedurë. Ekonomisti në detyrë na vendosi në dispozicion të gjitha dosjet e pagesës së tarifës për “CSZ” të dhënë nga drejtuesi i institucionit. Praktika e ndjekur nga Mzsh-ja në tarifimin e aplikimit (trajtuar të procedura), ka si vazhdimësi hartimin e akt detyrimit, i cili përpilohet të Mzsh-ja nga ekonomisti i saj, hartimin e faturës për arketim që përpilohet nga financa e bashkisë Berat dhe pagesa e kryer nga qytetari. Lejet e ndërtimit të periudhës së auditimit për të cilat është kërkuar mendim në lidhje me projektin e zjarrit si më poshtë:

	N r.	Nr. Në regjistrin	Lloji i Kërkeses	Lartësia/sipe rfaqe ndertimi/vle re investimi	Aplikanti	Miratim leje MZSh/D ate sistemi	Mendim MZSh-se/Date sistemi	Date pagese	Tarifa sipas Vkm-se/Detyrimi	Arketim	Diferenca
2021	1	5779	Leje ndërtimi	4.5 m	ALTUS ATELIER	16.12.2021	16.12.2021		5,000		5,000
	2	5645	Leje ndërtimi	4.5 m	Dashmira Tahiraj	11.11.2021	11.11.2021	25.11.2021	5,000	5,000	-
	3	5282	Leje ndërtimi	8.4m	TOTILA	22.10.2021	04.11.2021	22.11.2021	5,000	5,000	-
	4	4750	Leje ndërtimi	9.48m	Ardenis Hoxha	28.09.2021	24.09.2021	11.10.2021	5,000	5,000	-
	5	4709	Leje ndërtimi	12.56m	Ardenis Hoxha	28.09.2021	24.09.2021	27.10.2021	15,000	5000	10,000
	6	4314	Leje ndërtimi	8.16m	Çlirim Hoxhallari	13.09.2021	02.09.2021	15.09.2021	5,000	5,000	-
	7	4129	Leje ndërtimi	7 m	Anila Cane	12.10.2021	04.10.2021	12.10.2021	5,000	5,000	-
	8	3871	Leje ndërtimi	4.8m	Dashmira Tahiraj	05.08.2021	28.07.2021		5,000		5,000
	9	3697	Leje ndërtimi	7.6	Ardenis Hoxha	05.08.2021	28.07.2021		5,000		5,000
	10	3170	Leje ndërtimi	7.91m	Dashmira Tahiraj	09.07.2021	23/06/2021	26.07.2021	5,000	5,000	-
	11	2908	Leje ndërtimi	150m2	Arjana Marini	11.06.2021	23.06.2021	14.06.2021	5,000	5,000	-
	12	2834	Leje ndërtimi	4.8m	Dashmira Tahiraj	08.06.2021	01.06.2021	15.06.2021	5,000	5,000	-
	13	2835	Leje ndërtimi	5.1m	Valentina Jançe	16.06.2021	15.06.2021	24.06.2021	5,000	5,000	-
	14	2790	Leje ndërtimi	8.3m	TOTILA	11.06.2021	10.06.2021	16.06.2021	5,000	5,000	-
	15	2692	Leje ndërtimi	26m	"FLORJON" SHPK	15.06.2021	15.06.2021	16.06.2021	20,000	20,000	-
	16	2366	Leje ndërtimi	7.9m	Dashmira Tahiraj	08.06.2021	31.05.2021	16.06.2021	5,000	5,000	-
	17	2199	Leje ndërtimi	8.2m	Hasim Agaçi	06.05.2021	30.04.2021	26.05.2021	5,000	5,000	-
	18	1997	Leje ndërtimi	6.9m	Dashmira Tahiraj	21.04.2021	19.04.2021	04.05.2021	5,000	5,000	-

	19	1910	Leje ndërtimi	6.25m	Dashmira Tahiraj	09.04.2021	08.04.2021	12.04.2021	5,000	5,000	-
	20	1911	Leje ndërtimi	4m	Dashmira Tahiraj	09.04.2021	08.04.2021	13.04.2021	5,000	5,000	-
	21	1657	Leje ndërtimi	5.65	Ardenis Hoxha	25.03.2021	25.03.2021	30.03.2021	5,000	5,000	-
	22	1276	Leje ndërtimi	4.65	Dashmira Tahiraj	18.03.2021	04.03.2021	24.03.2021	5,000	5,000	-
	23	1169	Leje ndërtimi	8.17	Valentina Jançe	09.03.2021	01.03.2021	12.03.2021	5,000	5,000	-
	24	586	Leje ndërtimi	4.3m	Çlirim Hoxhallari	08.02.2021	29.01.2021	11.02.2021	5,000	5,000	-
2020	1	6041	Leje ndërtimi	9.46m	infinite R S	Nuk është shprehur me dhenie mendimi/leja konfirmuar		29.12.2020	5,000	5,000	
	2	5383	Leje ndërtimi	26m	Arber Durro	17.11.2020	16.11.2020		20,000	20,000	
	3	5168	Leje ndërtimi	15.15m	Adelina Bregaj	03.12.2020	24.11.2020	11.12.2020	15,000	15,000	-
	4	5084	Leje ndërtimi	4m	Valentina Jançe	03.12.2020	11.11.2020	11.12.2020	5,000	5,000	-
	5	3923	Leje ndërtimi	11.75m	Endrit Myrtaj	11.06.2020	10.09.2020	14.09.2020	5,000	5,000	-
	6	1811	Leje ndërtimi	< 20 mil	ARKONSTUDIO	29.05.2020	13.05.2020	29.05.2020	5,000	5,000	-
2019	1	6009	Leje ndërtimi	< 1 mil	Lefter Ndrio	15.01.2019	07.01.2019		500		500
	2	4663	Leje ndërtimi	< 20 mil	Hasim Agaçi	08.10.2019	30.09.2019		5,000		5,000
	3	4665	Leje ndërtimi	< 20 mil	Hasim Agaçi	08.10.2019	30.09.2019		5,000		5,000
	4	4521	Leje ndërtimi	< 1 mil	Lefter Ndrio	18.10.2019	14.10.2019		500		500
	5	4090	Leje ndërtimi	< 2 mil	Lefter Ndrio	04.09.2019	03.09.2019	04.09.2019	1,000	1,000	-
2018	1	5966	Leje ndërtimi	< 2 mil	Hasim Agaçi	11.10.2018	05.10.2018	10.10.2018	5,000	5,000	-
	2	5250	Leje ndërtimi	< 1 mil	Lefter Ndrio	06.09.2018	22.08.2018		500		500
	3	2264	Leje ndërtimi	< 2 mil	Çlirim Hoxhallari	15.05.2018	02.05.2018		5,000		5,000
	4	1435	Leje ndërtimi	< 1 mil	Ardenis Hoxha	24.04.2018	13.04.2018		500		500
	5	1167	Leje ndërtimi	< 2 mil	Çlirim Hoxhallari	29.03.2018	20.03.2018		5,000		5,000
Total									228,000	156,000	72,000

Për dosjet elektronike të para në bazë të Vkm-së e cila ka qënë në zbatim për tarifimin e procedurës së miratimit, rezulton diferenca 72,000 lekë e paarkëtuar për shërbimin e kryer. Pjesë përbërëse e këtij materiali do të jenë edhe të gjitha lejet e ndërtimit të konfirmuara në sistemin e-leje (133 leje të konfirmuara), për të cilat duhet ndjekur vazhdimësia e pagesës në pamundësi të kryhet nga auditi, i cili ka kontrolluar 40 prej tyre ose 30 % të lejeve.

Për të gjitha këto leje ndërtimi, nuk ka gjurmë të procedurës së dhënies së Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri sipas kreut III pika 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020, shprehet¹1. *Certifikata e Sigurisë nga Zjarri, në vijim “CSZ”, sipas formularit nr. 2 dhe 2.1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, është akti administrativ i lëshuar nga shërbimi i MZSH-së, brenda 30 ditëve nga paraqitja e kërkesës, nëpërmjet të cilit provohet përmbushja e kërkesave të parashikuara në projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit, sipas kategorizimit të objekteve.*2. *Aplikuesi për CSZ-në paraqet kërkesë nëpërmjet sistemit elektronik e-Albania, vetëm pasi kapërfunduar procesi i zhvillimit/i ndërtimit.* Tarifa për dhënien e kësaj certificate është e përcaktuar në Vkm-në nr. 607 date 29.07.2020, pika 7 ”Për dhënien e certifikatës së sigurisë nga zjarri, nga strukturat e shërbimit

të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për objektet që ushtrojnë aktivitete, sipas klasifikimit të rrezikshmërisë nga zjarri, tarifa është 5,000 (pesë mijë) lekë”. Mungesa e kësaj procedure ka shkaktuar mungesë të ardhurash për MZSh-në.

Gjetje:

3. Nuk është kryer inventarizimi fizik nga Drejtoria e Financës të letrave me vlerë që MZSH-ja disponon;
4. Magazina e Bashkisë Berat dhe magazina e Mzsh-se kanë bërë dalje të gjitha blloqet (dokumentacionin) e nevojshem për inspektim punonjësit së inspektimit në detyrë;
5. U konstatu mungesa e 1 (nje) blloku “Proces verbal konstatim shkelje”, i cila është bllok gjobash ose letra me vlerë që duhet të ndiqen me përgjegjësi të plotë nga personi që e ka në ngarkim;
6. Dokumentacionit shkresor për miratimet e lejeve të ndërtimit me miratimin në sistemin e-leje, ka anomali në lidhje me zbatimin e udhëzimit përkatës për kryerjen e procedurës. Miratimi është kryer nga titullari jashtë kriterëve ligjore për dhenien e tij;
7. Pagesa për miratimin e projektit të zjarrit dhe shpëtimit nuk është kryer për të gjitha dosjet e aplikuara në sistemin e-leje. Nuk ka gjurmë të procedurës së dhënies së Certifikatës së Sigurisë nga Zjarri;

Rekomandime:

3. Drejtoria e Financës duhet të administrojë blloqet e letrave dhe duhet ti ndjekë me nr. serial arkëtimin e tyre në përfundim të cdo blloku. Gjithashtu duhet të kryejë inventarizimin fizik të letrave me vlerë të paktën një herë në muaj në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 80;
4. Nga personeli i administrates së Mzsh-së, me detyrë magazinier të administrohen me përgjegjësi gjithë dokumentacioni i inspektimit duke mos i bërë dalje të gjitha llojet e blloqeve në sasi;
5. Nga MZSh-ja të gjendet gjurma shkresore e vijimësisë së bllokut të gjobave, i cili është në ngakim të znj. Mimoza Xhani me vlerën 150,000 (njqind e pesëdhjetëmijë) lekë. Ne rast te mos gjetjes së dokumentacionit, të ndiqet vjelja e dëmit të shkaktuar Bashkisë Berat;
6. Nga MZSh-ja në kryerjen e procedurës së miratim vlerësimit të projekteve të zjarrit të lejeve të ndërtimit të zbatohet me korrektësi Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020. Nga Bashkia Berat, për punonjësit e sektorit të inspektimit, të merren masa për mos zbatim të detyrave funksionale dhe në mos inspektim të projekteve të zjarrit dhe shpëtimit, drejtuesit të Mzsh-së për miratimin dhe vlerësimin e projektit të zjarrit dhe shpëtimit pa zbatueshmëri ligjore duke gjeneruar detyrime të paarkëtuara në kohë dhe të ardhura të munguara të Bashkisë Berat;
7. Nga MZSh-ja të ndiqet procedura e nxjerrjes së detyrimit për lejet e konfirmuara pa kryer pagesën në vlerën 72,000 (shtatëdhjetë e dymijë) lekë si dem ekonomik i shkatuar buxhetit të Bashkisë Berat. Nga MZSH-ja të rishihen të gjitha CSZ-të e dhëna dhe të veprohet në zbatim të kreut III të Udhëzimit nr. 81 datë 06.03.2020;

Gjetja nr. 3: Nuk është kryer inventarizimi fizik nga Drejtoria e Financës të letrave me vlerë që MZSH-ja disponon;	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
Përmbledhja e bazës ligjore	Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar,

Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nuk është kryer inventarizimi fizik nga Drejtoria e Financës të letrave me vlerë
	Kriteri: Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar
	Ndikimi/Efekti: Mungesë e 1(nje) blloku gjobash
	Shkaku:
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i lartë
Konkluzioni	
Rekomandimi	Drejtoria e Financës duhet të administrojë blloqet e letrave dhe duhet të ndjekë me nr. serial arkëtimin e tyre në përfundim të cdo blloku. Gjithashtu duhet të kryejë inventarizimin fizik të letrave me vlerë të paktën një herë në muaj në zbatim të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar, pika 80;

Gjetja nr. 4: Magazina e Bashkisë Berat dhe magazina e Mzsh-se kanë bërë dalje të gjitha blloqet (dokumentacionin) e nevojshem për inspektim punonjësit së inspektimit në detyrë;	
Subjekti i Audituar	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
Njësitë/subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtoria e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi
Përmbledhja e bazës ligjore	Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar;
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Magazina e Bashkisë Berat dhe magazina e Mzsh-se kanë bërë dalje të gjitha blloqet e inspektimit
	Kriteri: Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011, i ndryshuar
	Ndikimi/Efekti: Marrje dokumentacioni të panevojshëm
	Shkaku:
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	Risk i mesëm
Konkluzioni	
Rekomandimi	Nga personeli i administratës së Mzsh-së, me detyrë magazinier të administrohen me përgjegjësi gjithë dokumentacioni i inspektimit duke mos i bërë dalje të gjitha llojet e blloqeve në sasi;

